

Shoqëria e Sigurimeve



PJESË E  KASTRATI GROUP

rapporti vjetor 2025

MISIONI DHE VIZIONI.....	5
PROFILI I SHOQËRISË.....	6
MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM.....	7
STRUKTURA QEVERISËSE.....	8
VEPRIMTARIA NË SIGURIMIN JO-JETË TË SHOQËRISË.....	9

1. Strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut

1.1. Sistemi i menaxhimit të riskut.....	10
1.2. Zhvillimet e tregut të sigurimeve.....	10
1.3. Faktorët kryesorë të riskut.....	11
1.4. Plani i Menaxhimit të Riskut.....	11

2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë ALBSIG sha gjatë vitit 2025

2.1. Analizë SWOT për shoqërinë Albsig sh.a.....	13
--	----

3. Veprimtaria e Albsig për vitin 2025

3.1. Albsig Invest dhe Trajnimi mbi Fondet e Pensionit Privat dhe Fondet e Investimit.....	15
3.2. Zgjerimi i Rrjetit — Dega e Re në Pallatin me Shigjeta.....	15
3.3. Zyrë e re Albsig në zemër të Tiranës — më afër se kurrë!.....	16
3.4. Pashka në Albsig Harmoni, traditë dhe momente të paharruara.....	16
3.5. Një ditë e dedikuar argëtimit, bashkëpunimit dhe frymës së ekipit.....	17
3.6. Finalizimi i Fushatës Verore "A e sigurove verën tënde?".....	18
3.7. Nga siguria te investimi: Albsig mirëpret median në ambientet moderne të Downtown One.....	19
3.8. ALBSIG FESTON 21-VJETORIN! 21 vite besim, rritje dhe lidhshëm në tregun e sigurimeve.....	20
3.9. Trajnim për Inteligjencën Artificiale: Albsig forcon kapacitetet e stafit drejt inovacionit teknologjik.....	21

4. Përgjegjësia Sociale e Albsig për vitin 2025

4.1. Albsig, pjesëmarrës në Kampionatin e Biznesit të Federatës Shqiptare të Ping Pongut.....	22
4.2. Pjesëmarrja në Tourism & Travel Show Albania 2025.....	22
4.3. Panairi Work & Study 2025.....	22
4.4. ALBSIG, partner në AI Business Summit 2025.....	23
4.5. Albsig, një mundësi për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2025.....	24
4.6. Një ditë në Albsig, Aleksandra dhe Melisa pjesë e projektit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania!.....	24
4.7. Albsig, pjesëmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë.....	25
4.8. Albsig në Panairin e Karrierës të Western Balkans University.....	25
4.9. ALBSIG organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.....	25
4.10. ALBSIG në Samitin Ekonomik Shqipëri—Turqi: Një hap i ri drejt forcimit të partneritetit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm.....	26
4.11. ALBSIG për Tetorin Rozë: Kujdes, ndërgjegjësim dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes.....	27
4.12. Albsig në mbështetje të Movember: Nismë dedikuar parandalimit dhe kujdesit shëndetësor për burrat.....	28
4.13. ALBSIG forcon angazhimin në edukimin e brezave të rinj mbi rolin dhe vlerën e sigurimeve.....	29
4.14. ALBSIG mbështet projektin kinematografik "Kazerma" Një standard i ri në kinematografinë moderne shqiptare.....	30

5. Auditimi i brendshëm	
5.1. Misioni, Qëllimi dhe Objektivat Strategjike	31
5.2. Metodologjia, Analiza e Rrezikut dhe Plani i Punës	31
5.3. Deklarata e Pavarësisë	31
5.4. Struktura Organizative, Raportimi dhe Zhvillimi Profesional.....	31
5.5. Opinioni i Audituesit të Brendshëm (Viti Financiar 2025).....	32
6. Përmbushja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut	
6.1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve.....	33
6.2. Vlerësimi i risqeve	33
6.3. Kornizimi i riskut i shoqërisë Albsig Sh.a	34
6.4. Dëmet në shoqërinë Albsig Sh.a.....	36
6.5. Kuadri i Administrimit të Riskut	38
6.6. Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese	38
6.7. Aktive në mbulim të provigjoneve teknike	39
6.8. Marzhi i Aftësisë Paguese	40
6.9. Testi i rezultateve të marrjes në sigurim.....	42
6.10. Toleranca dhe kufijtë e riskut.....	43
6.11. Kufijtë për risigurim 2025	44
7. Kuadri i Raportimit	
7.1 Kontrollët e brendshme	45
7.1.1 Mjedisi i Kontrollit	45
7.1.2 Vlerësimi i Efektivitetit të Kontrolleve	46
7.2 Ngritja e reputacionit për të zgjeruar bazën konkurruese.....	46
8. Skenarët e stress-testeve	
8.1 Vetëvlerësimi i riskut, ORSA	47
8.2 Teste të paralajmërimit të hershëm	48
8.3 Planet e vazhdueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara.....	49
9. Raporti i audituesit të pavarur	
9.1 Opinioni i Auditorit të Jashtëm.....	50
9.2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar.....	53
9.3. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	54
9.4. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	55
9.5. Pasqyra individuale e flukseve monetare	56
9.6. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale.....	57
10. Objektivat strategjike dhe vjetore	
10.1 Objektivat strategjike dhe vjetore	60



ALBSIG



**PJESË E
KASTRATI GROUP**

Raporti vjetor i shoqërisë Albsig sh.a. për vitin 2025

Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17, 1010 – Tirana, Albania

+355 (0) 44502060 / +355 (0) 42254770

info@albsig.al

E drejta e autorit © 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohen, të ruhen në një sistem rikthimi.

MISIONI DHE VIZIONI



MISIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.



VIZIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.



FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



PROFILI I SHOQËRISË

→	Emri i Shoqërisë:	ALBSIG sh.a.
→	Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:	Z. Shfaqet Kastrati Z. Arben Breshani
→	Drejtor i Përgjithshëm:	Z. Muharrem BARDHOCI
→	Lokalizimi i zyrave qendrore:	Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17, 1010 - Tirana, Albania
→	Data e themelimit:	09 / 01 / 2004
→	Kapitali themeltar:	879,460,000 lekë
→	Numri i punonjësve:	250
→	Aktiviteti:	Në cilësinë e siguruesit të (Jo-Jetës)
→	Tel:	+355 4 22 54 770 +355 4 22 54 76
→	Website:	www.albsig.al
→	Kontakt:	info@albsig.al



MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar klientë, partnerë dhe bashkëpunëtorë,

Viti 2025 ishte një tjetër vit që vërtetoi se suksesi nuk matet vetëm me rezultatet financiare, por edhe me aftësinë për t'u përshtatur, për të inovuar dhe për të krijuar besim afatgjatë.

Në një mjedis ekonomik dhe gjeopolitik që vijon të karakterizohet nga pasiguria, ndryshimet klimatike, zhvillimet teknologjike dhe pritshmëritë gjithnjë e më të larta të klientëve, ALBSIG ka vazhduar të forcojë pozicionin e saj si një nga kompanitë lider të sigurimeve në Shqipëri.

Gjatë vitit 2025 kemi investuar në përmirësimin e përvojës së klientit, zgjerimin e kanaleve dixhitale, optimizimin e proceseve të brendshme dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit tonë. Besojmë se transformimi nuk është një projekt afatshkurtër, por një proces i vazhdueshëm që na lejon të ofrojmë shërbime më të shpejta, më transparente dhe më efikase.

Paralelisht, kemi vijuar të mbështesim komunitetin përmes iniciativave sociale, edukative dhe shëndetësore, duke besuar se përgjegjësia jonë shkon përtej ofrimit të produkteve të sigurimit. Si pjesë e Kastrati Group, ne mbetemi të përkushtuar të kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe në krijimin e një ndikimi pozitiv për shoqërinë.

Arritjet e këtij viti janë rezultat i besimit që klientët tanë na kanë dhënë, i profesionalizmit të rrjetit tonë të shitjes dhe i përkushtimit të çdo punonjësi të ALBSIG. Pikërisht ky kombinim na ka mundësuar të përballemi me sfidat, të ruajmë stabilitetin dhe të ndërtojmë themele edhe më të forta për të ardhmen. Ndërsa shohim drejt vitit 2026, do të vazhdojmë të investojmë në teknologji, inovacion, zhvillimin e produkteve dhe cilësinë e shërbimit, me një objektiv të pandryshuar: të jemi zgjedhja e parë e klientëve tanë dhe partneri i tyre më i besueshëm në menaxhimin e rrezikut.

Në emër të Bordit Drejtues dhe të gjithë ekipit të ALBSIG, ju falënderoj për besimin dhe bashkëpunimin tuaj. Besimi juaj është motivimi ynë më i madh për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt, së bashku.

Muharrem Bardhoci
Drejtore i Përgjithshëm





QEVERISJA E SHOQËRISË ALBSIG SH.A.

● Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

Shoqëria ALBSIG sh.a. është në pronësi të 1 aksionari
Z. Shefqet Kastrati 100 %

● Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:

Z. Shefqet Kastrati
Z. Arben Breshani

● Komitetet

1. Komiteti i Administrimit të Riskut
2. Komiteti i Auditimit të brendshëm

● Drejtor i Përgjithshëm

Z. Muharrem Bardhoci

● Departamentet / Degët

ALBSIG është i organizuar në 7 Departamente.

ALBSIG ka 25 degë, të vendosura në çdo qytet në Shqipëri.

Numri i të punësuarve është 250.

● Kapitali i nënshkruar

Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2025 është 879,460 mijë Lekë

Kapitali së bashku me fitimin e mbartur me 2025 është 23.5 (milion euro).



Albsig sh.a. është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Rruga e Barrikadave, (Pallatet 9 Katëshe) Nr.1001. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 janar 2004, dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numer identifikimi K42108801C.

Shoqëria operon sipas liçensës të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari sigurimi sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMF.

Liçenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a. e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:

- Grupi nr. 1 "Aksidente"
- Grupi nr. 2 "Sëmundjet"
- Grupi nr. 3 "Mjete tokësore" (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)
- Grupi nr. 4 "Mjete lëvizëse mbi shina"
- Grupi nr. 5 "Avionët"
- Grupi nr. 6 "Anijet"
- Grupi nr. 7 "Mallrat në transport"
- Grupi nr. 8 "Zjarri dhe forcat e natyrës"
- Grupi nr. 9 "Dëmtime të tjera të pasurisë"
- Grupi nr. 10 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve"
- Grupi nr. 11 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve"
- Grupi nr. 12 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve"
- Grupi nr. 13 "Përgjegjësitë civile të përgjithshme"
- Grupi nr. 14 "Sigurimi i kreditit" Licencimin e shoqërisë së sigurimit të Jo-Jetës Albsig sh.a., për zgjerimin e ushtrimit të veprimtarisë në klasën e 14-të të sigurimit. Me vendim nr. 21, datë 27.02.2020.
- Grupi nr. 15 "Garancitë"

1.1. Sistemi i menaxhimit të riskut:

- Përbën strategji, procese dhe procedura raportimi të nevojshme për të identifikuar, matur, menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme risqet, në nivel individual dhe të agreguar, të cilat janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe ndërvlerësitë e tyre.
- Integrohet në strukturën organizative dhe në proceset e vendimmarrjes.
- Mbulon risqet që duhet të përfshihen në llogaritjen e SCR, si dhe risqet që nuk janë të përfshira plotësisht në këtë llogaritje.

Ky raport përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në shoqërinë Albsig Sh.a., metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Referuar planit të 2025 që u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në Dhjetor 2024 u përpilua dhe Plani i Menaxhimit të Riskut për vitin 2025. Shoqëria Albsig Sh.a. në muajin Dhjetor 2025, në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, miratoi projektplanet për vitin 2026 dhe 3 vjeçar 2026 – 2028 dhe referuar këtij plani u përpilua dhe Plani i Menaxhimit të Riskut për vitin 2026.

**1.2. Zhvillimet e tregut të sigurimeve**

Tregu i sigurimeve vazhdoi të rritet në mënyrë të qëndrueshme në vitin 2025, i nxitur nga rritja e kërkesës për produkte të ndryshme sigurimesh nëpër sektorë të ndryshëm. Shoqëria Albsig Sh.a. shënoi rritje të qëndrueshme të primeve vullnetare, duke forcuar pozicionin e saj si lider në këtë segment të tregut. Luhatjet e normave të interesit, pritshmëritë në zhvillim të klientëve, ndërprerjet teknologjike dhe pasiguritë gjeopolitike parashtruan sfida të rëndësishme gjatë vitit, të cilat u adresuan nëpërmjet sistemit të menaxhimit të riskut të shoqërisë.

1.3. Faktorët kryesorë të riskut

- a. **Rreziqet e nënshkrimit:** Lohatjet në frekuencën dhe ashpërsinë e dëmeve, përzgjedhja e pafavorshme dhe modelet e pasakta të çmimeve. Ky risk matet dhe monitorohet nëpërmjet analizës së vazhdueshme të portofolit nënshkrues.
- b. **Rreziqet e tregut:** Paqëndrueshmëria në tregjet financiare, duke përfshirë lohatjet në vlerat e aktiveve dhe normat e interesit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në vlerën e portofolit të investimeve.
- c. **Rreziqet operacionale:** Kërcënimet e sigurisë kibernetike, ndërprerjet operacionale dhe kontrollet e brendshme joadekuate.
- d. **Rreziqet e kredisë:** Ekspozimi ndaj palëve të treta si risiguruesit, bankat dhe agjentët, i cili monitorohet nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë kreditore.
- e. **Rreziqet rregullatore:** Ndryshimet në kërkesat rregulatore dhe kostot e pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi.
- f. **Rreziqet klimatike dhe katastrofike:** Rritja e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së fatkeqësive natyrore, si pasojë e ndryshimeve klimatike.

1.4. Plani i Menaxhimit të Riskut

Plani i menaxhimit të riskut për vitin 2025 është hartuar në përputhje me kërkesat rregulatore të autoritetit dhe parimet ndërkombëtare të menaxhimit të riskut. Plani adresohet nga risqet që vijnë nga dështimi i funksionimit dhe sigurisë dhe kërkon rishikim të vazhdueshëm të strategjive.

Plani përfshin:

- Objektivat përkatëse dhe parimet kryesore
- Shpërndarjen e duhur të përgjegjësisë në të gjitha nivelet organizative
- Treguesit e paralajmërimit të hershëm
- Skenarët e stresit dhe analizën e sensitivitetit.

"Menaxhimi i Riskut është identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kërcënojnë pasuritë dhe parametrat financiarë të një shoqërie."

Parimet e menaxhimit të riskut mbështesin qasjen për të udhëhequr mirëmbajtjen dhe zhvillimin e strukturës së administrimit, duke përfshirë relacionet e qeverisjes së riskut, pronësisë së riskut dhe kulturës së riskut në të gjitha nivelet e organizatës.



Një nga sfidat kryesore për shoqërinë Albsig Sh.a. ishte rritja e konkurrencës në tregun e sigurimeve jo-jetë, e cila solli presion mbi marzhin e fitimit. Për të përballuar këtë sfidë, shoqëria përdori strategji të menaxhimit të riskut të përshtatura, duke shfrytëzuar analiza të avancuara të të dhënave për të përmirësuar vlerësimin e riskut dhe për të optimizuar portofolin e marrjes në sigurim.

Ndryshimet teknologjike në treg sollën nevojën për shoqërinë Albsig Sh.a. për të investuar në platforma dhe mjete të reja të teknologjisë së informacionit, me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit operacional. Në këtë kuadër, shoqëria implementoi Chat-Bot për përgjigjen e pyetjeve që kanë klientët në kohë reale duke përdorur inteligjencën artificiale (AI), zhvilloi aplikacione mobile dhe mundësinë e përdorimit të Whatsapp, për të lehtësuar blerjen dhe menaxhimin e policave të sigurimit për klientët.

Në fushën e sigurisë kibernetike, shoqëria Albsig Sh.a. ndërmori masa konkrete për mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve. Ndër masat e zbatuara gjatë vitit 2025 janë implementimi i autentifikimit me dy faktorë (2FA) për aksesin në sistemet e brendshme, si dhe zbatimi i politikave të menaxhimit të ndryshimeve (Change Management - CM) për të siguruar kontrollin e plotë mbi modifikimet në infrastrukturën teknologjike. Këto masa kanë forcuar ndjeshëm rezistencën operacionale të shoqërisë ndaj kërcënimeve kibernetike.

Në një mjedis gjithnjë e më të orientuar drejt transparencës dhe përputhshmërisë rregullatore, Albsig Sh.a. ka vendosur klientin në qendër të çdo vendimi strategjik. Gjatë vitit 2025, shoqëria intensifikoi përpjekjet për ofrimin e një përvoje të personalizuar dhe të thjeshtëzuar, duke përmirësuar ndjeshëm proceset e menaxhimit të pretendimeve dhe kanaleve të komunikimit me klientët. Investimet në dixhitalizim dhe shërbimin pas shitjes kanë kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e besimit dhe lojalitetit të klientëve, duke konsoliduar pozicionin e Albsig Sh.a. si një nga operatorët më të besueshëm në tregun e sigurimeve jo-jetë në Shqipëri.

Aktiviteti i shoqërisë edhe për vitin 2025 vlerësohet shumë pozitiv dhe i suksesshëm. Bilanci i shoqërisë rezulton me fitim. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2025 çoi në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë. Albsig Sh.a. që përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore. Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2025 ka shënuar progres të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a. në tregun e sigurimeve.

ALBSIG SH.A. mbyll vitin 2025 në nivele të kënaqshme duke ruajtur raportin e vullnetareve në nivelin 51.76 % më të lartë në treg dhe rritjen me veten me 9.11%.

- ▶ ALBSIG SH.A. renditet i 2-ti në treg duke zënë 19.09 % të tregut jo jetë, me rritjen me veten me 9.11 %, ndërkohë që tregu e ka rritjen 9.91%.
- ▶ ALBSIG SH.A. ka raportin më të lartë për produktet vullnetare 51.76 %, ndërkohë që tregu e ka 31.44 %.
- ▶ ALBSIG SH.A. vazhdon të ketë numrin më të vogël të dëmeve pezull (të papaguara) në 31.12.2025, çfarë evidenton pagesën në kohë rekord të dëmeve në zbatim dhe të kërkesave ligjore.
- ▶ ALBSIG SH.A. rendit i pari në produktet Kasko, Përgjegjësi, Përgjegjësi Ndërtuesi dhe Garanci.

Shoqëria Albsig Sh.a. edhe gjatë vitit 2025 është pozicionuar në vend të dytë në tregun e sigurimeve jo — jetë si rrjedhojë e një pune të vazhdueshme në vite shumë rezultative në linjat e produkteve vullnetare sidomos të Pronës, Përgjegjësi në vecanti Përgjegjësia e Ndërtuesit, Garancive, në produktin Kasko, Portofoli “Aksidente dhe Shëndet”..

Shoqëria, për vitin 2025 si dhe në vitet paraardhëse vazhdon të renditet e para në tregun e sigurimeve për produktin Kasko, Përgjegjësi dhe Garancitë, e dyta për sigurimet vullnetare duke patur raportin më të lartë në treg 51.76 % dhe tek produkti Zjarri dhe dëmtime të tjera në prone (Zjarri, Vjedhja dhe Sigurimi Inxhinierik).

- Për linjat e detyrueshme motorike, prezenca në treg për vitin 2025 është 13.43 % nga 13.44 % në 2024.
- Për sigurimet vullnetare, prezenca në treg për vitin 2025 është 31.43 % nga 31.08 % në vitin 2024 duke u pozicionur në vend të dytë.
- Shoqëria Albsig sh.a. gjatë vitit 2025 në treg zë 15.09 % të dëmeve të paguara bruto.



2.1 Analizë SWOT për shoqërinë Albsig sh.a.

Shoqëria Albsig Sh.a. shqyrton forcën dhe dobësinë e brendshme të saj, si dhe mundësitë dhe rreziqet që ndikojnë në mjedisin e jashtëm ku operon, me qëllim hartimin e një strategjie të qëndrueshme për vitin 2025:

Forcat:

- 1. Përvoja dhe Historia e Suksesit:** Albsig Sh.a. bazohet në një histori të gjatë suksesi prej mbi 21 vitesh në tregun e sigurimeve në Shqipëri, duke ndërtuar një reputacion të konsoliduar dhe një bazë të gjerë klientësh besnikë.
- 2. Lider në Sigurimet Vullnetare:** Shoqëria mban shkallën më të lartë të primeve vullnetare në treg, duke dëshmuar kapacitetin nënshkrues dhe besimin e klientëve ndaj produkteve të saj.
- 3. Përqëndrimi në Klient:** Fokusi në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të personalizuar, i mbështetur nga platformat dixhitale dhe aplikacionet mobile të zhvilluara gjatë vitit 2025, ka ndihmuar në rritjen e besimit dhe besnikërisë së klientëve.
- 4. Partneritetet Strategjike:** Partneritetet e konsoliduara me Kastrati Grup dhe institucione të tjera të tregut ofrojnë avantazhe konkurruese dhe mundësi të reja biznesi. Bashkëpunimi me risigurues ndërkombëtarë siguron mbulim të plotë të riskut katastrofik.
- 5. Siguria Kibernetike e Forcuar:** Gjatë vitit 2025, Albsig Sh.a. implementoi autentifikimin me dy faktorë (2FA) dhe politikat e menaxhimit të ndryshimeve (CM), duke forcuar ndjeshëm rezistencën operacionale ndaj kërcënimeve kibernetike.

Dobësitë:

1. **Mundësi për Inovacion të Mëtejshëm:** Dinamikat e shpejta të tregut kërkojnë investime të vazhdueshme në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve. Shoqëria ka identifikuar këtë fushë si prioritet strategjik për periudhën afatmesme, me synimin e diferencimit të mëtejshëm të ofertës së saj në treg.
2. **Optimizimi i Kostove Operative:** Shoqëria ka identifikuar mundësi për rritjen e efikasitetit operacional dhe optimizimin e strukturës së shpenzimeve në të gjitha departamentet, me synimin e përmirësimit të mëtejshëm të marzhit të fitimit dhe konkurrueshmërisë.
3. **Zgjerimi i Kanaleve të Shpërndarjes:** Shoqëria synon të vijojë diversifikimin e kanaleve të shpërndarjes, duke përfshirë kanalet dixhitale, partneritete të reja dhe zgjerimin gjeografik të rrjetit, për të arritur segmente të reja të tregut dhe për të forcuar prezencën ekzistuese.

Mundësitë:

1. **Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve:** Tregu i sigurimeve në Shqipëri ofron hapësirë të konsiderueshme për rritje, pasi niveli i sigurimit të popullsisë dhe bizneseve mbetet më i ulët krahasuar me vendet europiane. Kjo paraqet një mundësi të rëndësishme për Albsig Sh.a. për të zgjeruar portofolin e saj, veçanërisht në segmentin e sigurimeve vullnetare ku shoqëria është tashmë lider.
2. **Inovacioni Teknologjik:** Zhvillimi i mëtejshëm i produkteve dhe shërbimeve të bazuara në teknologji, si dhe përdorimi i programeve të analizës së të dhënave për vlerësimin e riskut, mund të çojë në diferencimin e mëtejshëm të Albsig në treg.
3. **Partneritetet e Reja Ndërkombëtare:** Bashkëpunimi me kompani dhe institucione ndërkombëtare mund të hapë dyer për produkte të reja dhe praktika më të mira të industrisë.

Rreziqet:

1. **Konkurrenca e Rritur:** Rritja e konkurrencës në tregun e sigurimeve jo-jetë mund të zvogëlojë marzhin e fitimit dhe të shtojë presionin për rritjen e cilësisë së shërbimeve.
2. **Ndryshimet Rregullatore:** Procesi i vazhdueshëm i harmonizimit të legjislacionit shqiptar të sigurimeve me direktivat europiane kërkon përshtatje të vazhdueshme të proceseve dhe strukturave organizative të shoqërisë.
3. **Rreziku i Ngjarjeve Katastrofike:** Ngjarjet e papritura si tërmetet, përmbytjet dhe fenomenet e tjera ekstreme klimatike mund të shkaktojnë kosto të mëdha dhe të ndikojnë negativisht në performancën financiare.
4. **Ndryshimet në Preferencat e Konsumatorëve:** Ndryshimet e shpejta në preferencat dhe nevojat e konsumatorëve, veçanërisht të gjeneratës së re dixhitale, kërkojnë përshtatje të vazhdueshme të ofertës së produkteve dhe kanaleve të shpërndarjes.



3.1 Albsig Invest dhe Trajnimi mbi Fondet e Pensionit Privat dhe Fondet e Investimit.

Në kuadrin e përmirësimit të njohurive të stafit dhe përshtatjes me risitë e tregut financiar, Albsig Invest ka nisur një trajnim intensiv me temën "Risitë në Fondet e Pensionit Privat dhe Fondet e Investimit".

Ky trajnim synon të forcojë njohuritë e punonjësve të Albsig mbi investimet afatgjata dhe mundësitë që ofrojnë këto fonde për klientët. Gjatë sesioneve, ekspertët e sektorit ndanë perspektivat e tyre mbi trendet e tregut, strategjitë e investimit dhe avantazhet që ofrojnë fondet për një të ardhme të sigurt financiare.



Trajnimet e brendshme përmes programit "Albsig Invest" kanë vijuar edhe gjatë muajit Mars, me një pjesëmarrje aktive nga stafi i degëve dhe drejtorive. Ky cikël trajnimesh synon rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e aftësive komunikuese dhe menaxhimin e situatave të ndryshme me klientët, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe besueshmërisë në treg. ALBSIG beson se investimi më i mirë është ai që bëhet te njerëzit — dhe përmes "Albsig Invest" ne sigurojmë që çdo anëtar i ekipit tonë të ndjehet i vlerësuar dhe i pajisur me njohuritë më të fundit të fushës.



3.2. Zgjerimi i Rrjetit — Dega e Re në Pallatin me Shigjeta.

Për të qenë gjithmonë më pranë klientëve tanë, ALBSIG ka zgjeruar rrjetin e degëve me një pikë të re shërbimi në një nga zonat më të frekuentuara të kryeqytetit — Pallati me Shigjeta. Kjo degë moderne do të ofrojë të gjitha shërbimet e sigurimit, me të njëjtin profesionalizëm, shpejtësi dhe korrektësi që na karakterizon. Stafi i përgatitur dhe ambienti mikpritës e bëjnë këtë degë një tjetër hap konkret drejt qëllimit tonë: t'i japim çdo klienti një eksperiencë të kënaqshme dhe të sigurt në çdo ndërveprim me ALBSIG.



3.3. Zyrë e re Albsig në zemër të Tiranës — më afër se kurrë!

Nga tani, jemi edhe më pranë klientëve tanë — Albsig ka hapur zyrën më të re në një nga lokacionet më ikonike të kryeqytetit: Sheshi Skënderbej. E vendosur në një pikë strategjike dhe lehtësisht të aksesueshme për të gjithë qytetarët, kjo zyrë do të ofrojë të gjitha shërbimet tona të sigurimit me të njëjtin standard profesionalizmi dhe kujdesi që na karakterizon.



Hapja e kësaj zyre është pjesë e angazhimit tonë për t'u zgjeruar me kujdes dhe për të qenë gjithmonë aty ku klientët kanë më shumë nevojë për ne — në qendër të jetës së përditshme, pranë bizneseve, institucioneve dhe komunitetit. Jeni të mirëpritur të na vizitoni për informacione, këshillim dhe çdo nevojë që lidhet me sigurimin tuaj.

3.4. Pashka në Albsig Harmoni, traditë dhe momente të paharruara

Festat janë më shumë sesa një shënim në kalendar — ato janë një mundësi për t'u ndalur, për të reflektuar dhe për të krijuar kujtime të bukura së bashku. Në Albsig, e kemi kthyer tashmë në traditë që çdo festë të shërbejë si një moment për të forcuar lidhjet midis nesh dhe për të rikujtuar vlerat që na bashkojnë. Me rastin e Pashkëve, stafi ynë u mbledh në ambientet e ngrohta të @foodlovers_al për të festuar në një atmosferë të qetë dhe plot ngjyra. Ngjyrosja e vezëve, një simbol i kësaj feste, u kthye në një aktivitet që solli jo vetëm krijimtari, por emocione dhe qetësi. Secili prej pjesëmarrësve kontribuoi në mënyrën e vet, duke sjellë qasje unike — nga ata që shfaqën kujdes në përzgjedhjen e ngjyrave dhe detajeve estetike, te ata që sollën humor dhe gjallëri, duke krijuar një ambient të ngrohtë dhe mikpritës për të gjithë.



Veçantia e këtij aktiviteti u pasurua edhe më tej me përgatitjen e një cheesecake-u të përbashkët, i cili u shijua me shumë kënaqësi. Ky gjest i thjeshtë përforcoi edhe një herë idenë se bashkëpunimi dhe ndarja e momenteve të përzemërta janë po aq të rëndësishme sa arritjet tona profesionale. Në Albsig, kujdesi ndaj njëri-tjetrit dhe kultivimi i një kulture të shëndetshme organizative mbeten gjithmonë në zemër të çdo iniciative. Momente të tilla janë dëshmi e frymës së respektit, solidaritetit dhe bashkëpunimit që na karakterizon.



3.5. Një ditë e dedikuar argëtimit, bashkëpunimit dhe frymës së ekipit

Në kuadër të iniciativave për fuqizimin e kulturës organizative dhe ndërtimin e një ambienti pune më të bashkuar, Albsig organizoi një retreat të dedikuar për stafin, që u zhvillua në ambientet e Tropikal Resort, Durrës. Aktiviteti u konceptua si një ditë larg rutinës së përditshme, me fokus te bashkëpunimi, komunikimi ndërpersonal dhe vlerësimi i përbashkët i rrugëtimit të kompanisë.

Gjatë ditës, pjesëmarrësit morën pjesë në një sërë lojërash argëtuese dhe sfidash të ndërtuara sipas formatit team-building, të cilat synonin të forconin lidhjet mes kolegëve dhe të nxisnin një frymë të shëndetshme bashkëpunimi dhe kreativiteti. Nga sfidat individuale deri te aktivitetet në grup, çdo moment ishte një mundësi për të reflektuar mbi rëndësinë e punës në skuadër dhe komunikimit efektiv.

Një nga momentet më të veçanta të ditës ishte organizimi i një quiz-i mbi historikun dhe arritjet e Albsig, që shërbeu si një mënyrë interaktive për të kujtuar pikat kyçe të zhvillimit të kompanisë dhe për të nxitur ndjenjën e përkatësisë. Pyetjet përfshinin fakte historike, të dhëna rreth produkteve dhe nismave më të rëndësishme që kanë ndërtuar profilin e Albsig në tregun e sigurimeve.

Pjesëmarrja entuziaste dhe energjia pozitive e stafit konfirmuan edhe një herë rëndësinë e këtyre aktiviteteve për motivimin dhe angazhimin e brendshëm. Ky retreat nuk është thjesht një ditë argëtimi, por një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi rrugëtimin e përbashkët dhe për të forcuar më tej lidhjet që e bëjnë një ekip të suksesshëm.

Aktivitete të tilla janë tashmë pjesë e kalendarit të përvitshëm të kompanisë dhe përfaqësojnë përkushtimin e Albsig për të ndërtuar një kulturë pune ku bashkëpunimi, mirëqenia dhe motivimi i stafit qëndrojnë në themel të çdo suksesi.






3.6. Finalizimi i Fushatës Verore “A e sigurove verën tënde?”

Muaji Gusht shënoi përfundimin e fushatës sonë verore “A e sigurove verën tënde?”, e cila pati një ndikim të gjerë tek klientët tanë në mbarë vendin. Fushata u fokusua në ndërgjegjësimin për sigurimin e pushimeve, udhëtimeve, shëndetit dhe banesave, duke i ofruar klientëve qetësi dhe mbrojtje gjatë gjithë sezonit turistik.

Rezultatet treguan rritje të ndjeshme në policat e sigurimit të shëndetit në udhëtim, banesave dhe bizneseve akomoduese kaq të frekuentuara sidomos gjatë sezonit turistik, çka dëshmon qartë besimin e tregut ndaj shërbimeve të ALBSIG. Me këtë fushatë, ne forcua rolin tonë si partneri i besuar i qytetarëve dhe bizneseve edhe gjatë periudhës më dinamike të vitit.



3.7. Nga siguria te investimi: Albsig mirëpret median në ambientet moderne te Downtown One

ALBSIG, pjesë e Grupit Kastrati, mirëpriti përfaqësues të mediave në ambientet e reja në ndërtesën ikonike Downtown One, ku u zhvillua një konferencë për shtyp me drejtues të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest, pasuar nga një tur ekskluziv i hapësirave moderne të kompanive. Ky aktivitet shënoi një moment të rëndësishëm për Albsig, duke reflektuar filozofinë e investimeve afatgjata, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në tregun shqiptar të sigurimeve dhe financave.

Në fjalën e tij, Plarent Hamzaj, Z.v. Drejtor i Përgjithshëm i ALBSIG, theksoi se qëndrueshmëria dhe besimi janë themelet mbi të cilat Shoqëria ka ndërtuar zhvillimin e saj ndër vite. Ai vuri në dukje se investimi i vazhdueshëm në inovacion, teknologji dhe përmirësimin e përvojës së klientit ka kthyer korrektësinë dhe transparencën në shtylla të pandashme të kulturës së punës së Albsig. Hamzaj shtoi se vizioni i ALBSIG është të mbetet një partner afatgjatë dhe i besueshëm për klientët dhe institucionet financiare, duke kontribuar në forcimin e industrisë së sigurimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut shqiptar. Sipas tij, vlera e një kompanie nuk matet vetëm me përmasën e saj, por me mënyrën se si ajo qëndron pranë klientëve në momentet vendimtare, një parim që e ka bërë Albsig një emër të respektuar për më shumë se dy dekada.



Në vijim, Dritan Kastrati, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i ALBSIG, theksoi se rezultatet e kompanisë në trajtim dhe pagesë dëmsh janë dëshmi e qartë e korrektësisë dhe seriozitetit që e karakterizon. Prej më shumë se një dekade, Albsig renditet ndër liderët e tregut për shlyerjen e dëmeve, me mbi 150 mijë klientë të dëmshpërblyer, ndërsa vetëm në vitin e kaluar 17,157 klientë përfituan dëmshpërblimin e tyre. Ai theksoi se Albsig mban numrin më të ulët të dëmeve pezull, vetëm 4% të totalit të tregut, si dhe numrin më të ulët të proceseve gjyqësore, çka dëshmon efikasitetin dhe transparencën e shoqërisë. Sipas tij, këta tregues janë rezultat i standardeve të larta të përgjegjshmërisë ndaj klientit, që kanë ndërtuar reputacionin e Albsig si një kompani me baza të forta financiare dhe besueshmëri të qëndrueshme në tregun shqiptar dhe rajonal.

Pas konferencës, përfaqësuesit e mediave morën pjesë në një tur të organizuar në ambientet e ALBSIG, ku u njohën nga afër me hapësirat bashkëkohore të punës, sallat e trajnimit dhe qendrat e komunikimit me klientët të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest. Ky investim, që përfaqëson besimin e Grupit Kastrati në potencialin e tregut shqiptar, tregon se standardet europiane janë tashmë një realitet që po ndërtohet çdo ditë në zemër të Tiranës.

3.8. ALBSIG FESTON 21-VJETORIN! 21 vite besim, rritje dhe lidhshëm në tregun e sigurimeve

Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG kremtoi 21-vjetorin e themelimit me një event festiv të organizuar në ambientet e hollit të Drejtorisë Qendrore në Downtown One, ku morën pjesë drejtues, partnerë dhe punonjës nga të gjitha njësitë e shoqërisë. Ngjarja u karakterizua nga një atmosferë e ngrohtë dhe miqësore, tipike për kulturën e ALBSIG, duke reflektuar harmoninë dhe frymën e bashkëpunimit që e shoqëron shoqërinë prej dy dekadash.

21 vjet



Në fjalën e tij përshëndetëse, Drejtori i Përgjithshëm vlerësoi kontributin e çdo punonjësi në rrugëtimin e deritanishëm, duke nënvizuar se suksesi i ALBSIG është rezultat i përkushtimit, profesionalizmit dhe besimit të ndërsjellë mes ekipit, klientëve dhe partnerëve. Ai evidentoi arritjet kryesore të Shoqërisë në këto 21 vite, ndër të cilat spikasin pozicionimi si lider në treg në produktet vullnetare të sigurimit, rritja e vazhdueshme e portofolit dhe forcimi i pranisë në tregun vendas.

Gjithashtu, ALBSIG mbetet e pakonkurrueshme në pagesën e dëmeve në kohë rekord, duke e kthyer shërbimin cilësor dhe transparencën në një standard të pandashëm të veprimitarisë së saj. Ky angazhim ndaj klientit ka qenë dhe mbetet një ndër shtyllat kryesore të filozofisë së kompanisë. Gjatë eventit u vlerësuan jo vetëm të ardhurat financiare dhe operationale, por edhe rrugëtimi njerëzor i Shoqërisë. Atmosfera e ngrohtë dhe solidariteti mes punonjësve krijuan një moment reflektimi dhe motivimi për sfidat dhe objektivat e ardhshme.

21 vite ALBSIG përfaqësojnë 21 vite investim në inovacion, profesionalizëm dhe shërbim të dedikuar ndaj klientit, një histori suksesi që vijon të ndërtohet çdo ditë. Shoqëria shikon drejt së ardhmes me besim dhe vendosmëri për të mbetur një ndër aktorët kryesorë të tregut të sigurimeve në Shqipëri.



3.9. Trajnim për Inteligjencën Artificiale: Albsig forcon kapacitetet e stafit drejt inovacionit teknologjik

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e proceseve të punës përmes teknologjisë, Shoqëria e Sigurimeve Albsig organizoi një trajnim të dedikuar mbi Inteligjencën Artificiale (AI), mbajtur nga eksperti ndërkombëtar Josh Miekley.

Trajnimi, i zhvilluar me pjesëmarrjen e punonjësve të Drejtorisë Qendrore, pati në fokus mënyrat praktike se si inteligjenca artificiale mund të përdoret për të rritur efikasitetin, automatizuar detyra të përsëritura dhe për të lehtësuar proceset analitike në përditshmërinë e punës.

Gjatë sesionit, z. Miekley ndau një panoramë të gjerë mbi zhvillimet më të fundit në fushën e AI-së, duke ilustruar raste konkrete se si kjo teknologji po transformon industrinë financiare dhe atë të sigurimeve në mbarë botën. Pjesëmarrësit u njohën me mjete praktike që mund të ndihmojnë në krijimin e përmbajtjeve më efikase, analizimin e të dhënave, përmirësimin e komunikimit me klientët dhe mbështetjen e inovacionit të brendshëm. Në vijim të trajnimit, u theksua rëndësia e qasjes etike dhe të përgjegjshme në përdorimin e inteligjencës artificiale, duke respektuar standardet e sigurisë, transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave.

Ky aktivitet shënon një tjetër hap të rëndësishëm në strategjinë e Albsig për të integruar teknologjitë e reja në shërbim të klientit dhe të performancës institucionale, duke nxitur një kulturë inovacioni brenda organizatës. Trajtime të tilla janë pjesë e vizionit tonë për të investuar jo vetëm në teknologji, por edhe në njerëzit tanë. Inteligjenca Artificiale përfaqëson një mundësi të madhe për të rritur produktivitetin, kreativitetin dhe cilësinë e shërbimit që u ofrojmë klientëve. Në përfundim, stafi pjesëmarrës vlerësoi trajnimin si një përvojë frymëzuese dhe praktike, që hap horizonte të reja për përdorimin e AI-së në funksion të zhvillimit profesional dhe organizativ të Albsig.



4.1. Albsig, pjesëmarrës në Kampionatin e Biznesit të Federatës Shqiptare të Ping Pongut

Në vazhden e angazhimit të saj për promovimin e një stili jetese të shëndetshme dhe për mbështetjen e aktiviteteve sportive, ALBSIG mori pjesë në Kampionatin e Biznesit të Federatës Shqiptare të Ping Pongut. Ky event, i cili mbledhi kompani të ndryshme nga sektori privat, ishte një mundësi e shkëlqyer për të forcuar marrëdhëniet midis bizneseve dhe për të promovuar rëndësinë e aktivitetit fizik në ambientet e punës. Ekipi i ALBSIG u përfaqësua me një performancë të shkëlqyer, duke reflektuar jo vetëm frymën sportive, por edhe angazhimin e kompanisë për të ndërtuar një komunitet biznesi të shëndetshëm dhe të lidhur. Ky event tregoi se sporti dhe biznesi mund të ecin paralelisht, duke sjellë përfitime për të gjithë pjesëmarrësit.



Përgjegjësia sociale është konsideruar një shtyllë thelbësore e filozofisë së Albsig, dhe është konkretizuar përmes një sërë nismash me impakt të drejtpërdrejtë në komunitet dhe mjedis. Albsig ka mbështetur institucionet arsimore në përmirësimin e kushteve të të nxëniet dhe edukimit, ka organizuar dhe mbështetur fushata të ndërgjegjësimit mjedisor me qëllim promovimin e sjelljeve të qëndrueshme, si dhe ka ofruar ndihmë të vazhdueshme për kategori të ndryshme të shoqërisë në nevojë, duke synuar fuqizimin social dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Shoqëria ka qenë gjithashtu një mbështetëse aktive e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive, si për të rinjtë ashtu edhe për të rriturit, duke kontribuar në promovimin e një jete komunitare të gjallë dhe gjithëpërfshirëse. Përmes këtij angazhimi të shumëanshëm, Albsig ka afirmuar vizionin e saj për të qenë më shumë se një kompani sigurimesh, një faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme.

4.2. Pjesëmarrja në Tourism & Travel Show Albania 2025

Në këtë panair të rëndësishëm, i mbajtur në Pallatin e Kongreseve, ALBSIG prezantoi produktet e saj të sigurimit në udhëtim dhe paketat e dedikuara për turistët dhe bizneset në industrinë e turizmit. Përfaqësuesit e kompanisë patën mundësinë të komunikojnë drejtpërdrejt me operatorët turistikë, hotelet dhe individët e interesuar, duke theksuar avantazhet e sigurimeve të personalizuar për udhëtarët dhe bizneset turistike.



4.3. Panairi Work & Study 2025

Në datat 27-28 shkurt, ALBSIG ishte pjesë e këtij panairi të rëndësishëm të karrierës dhe edukimit. Ky event është një mundësi e shkëlqyer për të prezantuar mundësitë e punësimit dhe zhvillimit profesional brenda kompanisë. ALBSIG ofroi informacion mbi pozicionet e hapura, trajnimet dhe mundësitë e karrierës në sektorin e sigurimeve, duke inkurajuar të rinjtë të bëhen pjesë e një kompanie me vizion.

dhe stabilitet në treg. Nëpërmjet këtyre angazhimeve, ALBSIG vazhdon të mbështesë komunitetin, edukimin dhe zhvillimin profesional, duke u afirmuar si një kompani e përkushtuar ndaj inovacionit dhe shërbimit cilësor.



4.4. ALBSIG, partner në AI Business Summit 2025

Më 24 Prill 2025, ALBSIG mori pjesë si partner në AI BUSINESS SUMMIT 2025, një ngjarje madhore e organizuar në bashkëpunim me Accenture, në ambientet e Innovation Hub, Piramida. Duke mbështetur këtë samit si sponsor, ALBSIG riafirmoi angazhimin e tij ndaj inovacionit dhe teknologjisë si shtylla të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të sigurimeve dhe për transformimin digjital të shërbimeve ndaj klientit.

Samiti mbledhi mbi 150 pjesëmarrës, përfshirë drejtues të industrisë, politikëbërës dhe ekspertë të inteligjencës artificiale, duke krijuar një hapësirë ku u shkëmbyen ide, eksperiencë dhe vizione për të ardhmen. Për ALBSIG, ky partneritet shërbeu si një mundësi e vyer për të rritur dukshmërinë e markës, për të forcuar pozicionimin si një kompani që përqafon risitë dhe për të ndërtuar marrëdhënie të reja me vendimmarrës nga fusha të ndryshme të biznesit dhe teknologjisë. Pjesëmarrja në këtë event theksoi edhe një herë orientimin strategjik të ALBSIG për të qenë afër inovacionit dhe afër klientëve, në një treg që po evoluon me ritme të shpejta.





4.5. Albsig, një mundësi për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2025

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, mori pjesë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2025 të organizuar nga Fakulteti i Biznesit, UAMD. Albsig mirëpriti studentë e të rinj të interesuar për mundësi punësimi dhe praktika profesionale, shumë prej të cilëve shprehën interes për t'u bërë pjesë e stafit ose për të ndjekur internshipet e kërkuara nga programet akademike.

Aktivitetet të tilla, theksojnë rëndësinë e përafrimit të arsimit me tregun e punës. Pjesëmarrja e personaliteteve të ndryshme prezent, e shtoi edhe më tej rëndësinë e këtij aktiviteti tashmë tradicional, duke siguruar që studentët të jenë gati për sfidat e ardhshme profesionale. Albsig mbetet një mbështetës i fuqishëm i brezit të ri dhe promovimit të karrierës së tyre.

4.6. Një ditë në Albsig, Aleksandra dhe Melisa pjesë e projektit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania

Në mbështetje të programit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania, ishin me ne në Albsig, Aleksandra Bami dhe Melisa Lazi. Gjimnazistet u bënë pjesë e stafit drejtues të kompanisë për një ditë, u njohën me drejtuesit e kompanisë dhe njëkohësisht panë më nga afër të gjithë punën e departamenteve të shoqërisë Albsig dhe Albsig Invest.

Melisa ka qëndruar përgjatë një dite në Departamentin e Marketingut dhe ka parë më nga afër punën e këtij departamenti, ndërkohë që Aleksandra shoqëroi Z. Elton Korbi, Drejtor i Përgjithshëm i Albsig Invest në angazhimet dhe takimet e ditës. Besojmë se nisma të tilla janë thelbësore për të ndërtuar ura të forta mes edukimit dhe tregut të punës. Të rinjtë kanë nevojë për më shumë eksperiencë reale, mentorim profesional dhe ekspozim ndaj sfidave të punës së përditshme, në mënyrë që të formësojnë më qartë aspiratat dhe aftësitë e tyre.



4.7. Albsig, pjesmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë

Albsig, pjesë e Kastrati Group, mori pjesë në Panairin e Punës të organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Kompania tërhoqi vëmendjen e shumë studentëve energjikë, të motivuar dhe me synime të qarta profesionale. Interesi i tyre i lartë për t'u njohur nga afër me kompaninë dhe për të eksploruar mundësi punësimi apo praktika profesionale tregoi potencialin dhe ambicien që karakterizon brezin e ri. Shumë prej tyre shprehën dëshirën për t'u bërë pjesë e stafit të Albsig ose për të ndjekur internshipe pranë kompanisë. Albsig vazhdon të mbështesë me përkushtim të rinjtë, duke u ofruar mundësi konkrete për rritje profesionale dhe zhvillim të mëtejshëm në tregun e punës.



4.8. Albsig në Panairin e Karrierës të Western Balkans University

Western Balkans University, në bashkëpunim me Dhomën Britanike të Tregtisë në Shqipëri, organizoi edicionin e dytë të Panairit të Karrierës, që solli së bashku mbi 60 biznese dhe institucione për t'u ofruar studentëve një pasqyrë reale të botës së punës. Albsig, pjesë e Kastrati Group, ishte krenare të ishte pjesë e këtij aktiviteti, duke sjellë në stendën e saj eksperiencën dhe energjinë e një ekipi të përkushtuar.

Studentët e WBU u treguan mjaft të interesuar për mundësitë e internshipeve dhe bashkëbiseduan me ekspertët tanë për të kuptuar më mirë si mund të integrohen në tregun e punës. Për shumë prej tyre, ky panair ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt një karriere të suksesshme. Albsig, si gjithmonë, mbështet iniciativat që nxisin zhvillimin profesional të të rinjve dhe i orienton ata drejt mundësive konkrete për praktikë dhe punësim.



4.9. ALBSIG organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për përgjegjësi sociale dhe mbështetje ndaj komunitetit, ALBSIG organizoi në ambientet e drejtorisë qendrore një aktivitet dedikuar dhurimit vullnetar të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Nën moton **"Dhuro gjak, shpëto jetë"**, punonjës të kompanisë u bënë pjesë aktive e një procesi jetik për sistemin shëndetësor në vend.

Dhurimi i gjakut është një ndër aktet më domethënëse të solidaritetit dhe një nevojë e vazhdueshme për trajtimin e pacientëve që përballen me emergjencë mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale, apo sëmundje kronike. Përmes kësaj iniciative, ALBSIG synon të përçojë mesazhin se secili prej nesh mund të bëjë një ndryshim të vërtetë në jetën e dikujt, me një akt të thjeshtë, por me ndikim të madh.



Nisma është pjesë e kalendarit të veprimtarive të kompanisë që mbështesin kauza sociale dhe kontribuojnë në mirëqenien kolektive. Ne e shohim përgjegjësinë sociale jo thjesht si pjesë të identitetit tonë korporativ, por si një detyrim moral për të qenë pranë komunitetit në momente dhe forma që kanë rëndësi reale. Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar ka qenë thelbësor për realizimin e kësaj dite, duke siguruar standardet e duhura mjekësore, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e stafit në një atmosferë organizative shembullore.



ALBSIG mbetet e angazhuar për të vijuar mbështetjen e kauzave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës në shoqëri, duke fuqizuar rolin e saj si një kompani që kujdeset jo vetëm për sigurinë financiare, por edhe për jetën.

4.10. ALBSIG në Samitin Ekonomik Shqipëri—Turqi: Një hap i ri drejt forcimit të partneritetit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG mori pjesë në hapjen e Samitit Ekonomik Shqipëri—Turqi, organizuar nga MÜSIAD Albania, një aktivitet i rëndësishëm që vuri në qendër bashkëpunimin strategjik ndërmjet dy vendeve në fushat e turizmit, kulturës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ky forum shënon një tjetër hap përpara në forcimin e marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Turqisë, duke krijuar mundësi të reja për investime, shkëmbime tregtare dhe bashkëpunime afatgjata, veçanërisht në sektorin e turizmit, një nga motorët kryesorë të zhvillimit të ekonomisë shqiptare.



Ngjarja mbledhi përfaqësues të bizneseve, institucioneve dhe qeverive nga të dy vendet, të cilët ndanë vizionin e përbashkët për forcimin e urave ekonomike dhe kulturore që lidhin Shqipërinë dhe Turqinë. Në qendër të diskutimeve u theksua rëndësia e partneriteteve të qëndrueshme, që nxisin zhvillimin ekonomik, turizmin cilësor dhe inovacionin në të dy tregjet. Një pjesë e rëndësishme e Samitit ishte Albania—Türkiye Investment Forum 2025, ku u zhvilluan takime B2B mes dhjetëra bizneseve shqiptare dhe turke. Këto takime krijuan hapësirën e duhur për shkëmbim idesh, ndërtim partneritetesh të reja dhe konkretizim projektsh të përbashkëta, duke e kthyer bashkëpunimin në veprim real. Energjia pozitive, kontaktet e reja dhe iniciativat që morën jetë gjatë forumit treguan se e ardhmja e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Turqisë është më afër se kurrë.

Pjesëmarrja e ALBSIG në këtë samit përforcon angazhimin e shoqërisë për të qenë pjesë aktive e dialogut ekonomik rajonal, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e mundësive të reja për investime. Si pjesë e Grupit Kastrati, ALBSIG ndan të njëjtin vizion për bashkëpunim ndërkombëtar, inovacion dhe integrim ekonomik, duke kontribuar në forcimin e partneriteteve që sjellin vlerë të shtuar për bizneset dhe komunitetin. Ky samit përfaqëson jo vetëm një platformë bashkëpunimi ekonomik, por edhe një urë miqësie dhe zhvillimi të qëndrueshëm midis dy vendeve që ndajnë histori, kulturë dhe vizion të përbashkët për të ardhmen.

4.11. ALBSIG për Tetorin Rozë. Kujdes, ndërgjegjësim dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes

Në kuadër të Tetorit Rozë dhe si pjesë e traditës së përvitshme të ALBSIG, janë mundësuar kontrolle falas për eko gjiri pranë Klinikës Wellness për të gjitha koleget e shoqërisë. Kjo nismë vjen si pjesë e angazhimit të ALBSIG për të mbështetur ndërgjegjësimin mbi parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, një kauzë me rëndësi të veçantë për komunitetin dhe shëndetin e grave. Për ALBSIG, kujdesi ndaj shëndetit nuk është vetëm përgjegjësi personale, por një vlerë që përqafojmë së bashku. Kjo mundësi e ofruar për stafin tonë është shprehje e bindjes se parandalimi dhe kontrolli i rregullt janë hapat më të rëndësishëm drejt shëndetit dhe jetës së sigurt. Çdo vit, ALBSIG e përforcon këtë traditë si shenjë solidariteti, kujdesi dhe mbështetjeje, duke kujtuar se shëndeti i çdo gruaje është një prioritet që na bashkon të gjithëve. Sepse në ALBSIG, kujdesi është pjesë e kulturës sonë — dhe çdo hap i vogël për shëndetin, është një hap i madh për jetën.



Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit, një kauzë që çdo vit na kujton rëndësinë e kujdesit, kontrollit dhe parandalimit. Në kuadër të Tetorit Rozë, ALBSIG zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi me moton: “Në ndihmë të vajzave dhe grave për diagnostikimin sa më të hershëm të çdo problematike shëndetësore, me fokus në kancerin e gjirit.” Ky muaj mbart një mesazh të fortë solidariteti dhe kujdesi, duke ftuar çdo vajzë e grua të marrë kohën për t’u informuar dhe për të bërë kontrollet periodike. Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm shpëtojnë jetë. Në shenjë sensibilizimi dhe mbështetjeje, ALBSIG — pjesë e Kastrati Group — bashkohet edhe këtë vit me fushatën Tetori Rozë, duke qenë përkrah çdo gruaje në këtë betejë të rëndësishme për shëndetin dhe jetën. Sepse shëndeti është pasuria më e çmuar, dhe kujdesi për veten është hapi i parë drejt një të ardhmeje të sigurt. Ne në ALBSIG besojmë se siguria nuk kufizohet vetëm te pasuritë dhe asetet materiale — ajo fillon nga shëndeti. Prandaj, ju inkurajojmë që gjatë këtij muaji të bëni kontrollin e gjirit dhe ta bëni këtë një pjesë të zakonshme të kujdesit tuaj personal.

4.12. Albsig në mbështetje të Movember Nismë dedikuar parandalimit dhe kujdesit shëndetësor për burrat

Në kuadër të muajit nëntor, i njohur ndërkombëtarisht si “Movember” dhe i dedikuar ndërgjegjësimit mbi shëndetin e burrave, Albsig në bashkëpunim me Spitalin “Zoja e Këshillit të Mirë” ka ndërmarrë një nismë të përbashkët që synon rritjen e informimit mbi kancerin e prostatës dhe rëndësinë e kontrolleve të hershme. Kompania lider në tregun e sigurimeve, Albsig, po financohet paketën e kontrollit parandalues, duke u mundësuar burrave kryerjen e analizave dhe ekzaminimeve të nevojshme pranë Spitalit “Zoja e Këshillit të Mirë”. Qëllimi mbetet i qartë: të inkurajohet sa më gjerësisht informimi dhe realizimi në kohë i kontrolleve rutinë.

Spitali “Zoja e Këshillit të Mirë” do të ofrojë paketat e check-up me çmime të reduktuara për stafin e Fondacionit dhe për klientët e Albsig, ndërsa ekipi mjekësor do të kryejë ekzaminimet dhe do të ofrojë këshilla praktike mbi rëndësinë e zbulimit të hershëm të kancerit të prostatës. Kjo nismë synon gjithashtu të adresojë dhe të zvogëlojë barrierat apo paragjykimet që shpesh shoqërojnë diskutimet rreth shëndetit të burrave. Albsig, pjesë e Grupit Kastrati, prej vitesh mbështet iniciativë që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e komunitetit.

Fushata e këtij nëntori është pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të kompanisë për të qenë pranë individëve jo vetëm përmes produkteve të sigurimit, por edhe përmes nismave që nxisin parandalimin dhe kujdesin e hershëm. Kanceri i prostatës mbetet një nga format më të përhapura të kancerit tek burrat, veçanërisht pas moshës 50 vjeç. Në shumë vende ai renditet midis tre llojeve më të shpeshta të kancerit tek meshkujt. Në shumicën e rasteve, diagnostikimi në fazat e hershme e bën trajtimin më të thjeshtë dhe me rezultate të favorshme, ndaj mjekët rekomandojnë kryerjen e kontrolleve periodike, veçanërisht për personat me faktorë rreziku si moshë, historiku familjar apo problematika të mëparshme të prostatës.



Përveç kësaj fushate, Albsig ofron një gamë të gjerë paketash shëndeti përmes Kartave të Shëndetit, të strukturuar sipas nevojave të individëve dhe familjeve. Këto paketa përfshijnë vizita mjekësore, analiza, imazheri dhe shërbime të tjera shëndetësore, duke e bërë kujdesin mjekësor më të aksesueshëm, më gjithëpërfshirës dhe më të përshtatshëm për të siguruarit.

4.13. ALBSIG forcon angazhimin në edukimin e brezave të rinj mbi rolin dhe vlerën e sigurimeve

Në kuadër të misionit të saj për të promovuar kulturën e sigurimit dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të të rinjve, ALBSIG ka intensifikuar aktivitetet e bashkëpunimit me institucione arsimore, duke krijuar ura komunikimi dhe edukimi që synojnë ndërtimin e një gjenerate më të informuar, më të ndërgjegjshme dhe më të përgatitur për tregun e punës

Vizita e studentëve të Turgut Ozal në Drejtorinë Qendrore të ALBSIG

ALBSIG mirëpriti në ambientet e saj një grup studentësh nga Turgut Ozal, të cilët patën mundësinë të njihen nga afër me funksionimin e Shoqërisë dhe rolin e sigurimeve në jetën e përditshme. Përfaqësues nga departamente të ndryshme prezantuan informacione të vlefshme mbi rëndësinë e sigurimeve si element që garanton stabilitet financiar për individët dhe bizneset, si dhe ndikimin që kjo industri ka në zhvillimin e ekonomisë. Gjatë takimit u theksuan gjithashtu mundësitë e shumta që ALBSIG ofron si partner i besueshëm për mbrojtjen financiare në çdo etapë të jetës, duke i orientuar studentët mbi rëndësinë e njohurive rreth këtij sektori për të ardhmen e tyre profesionale.

Angazhimi i ALBSIG me Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë

Në vijim të përpjekjeve për të kontribuar në edukimin financiar të brezave të rinj, stafi i ALBSIG zhvilloi një vizitë në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë, ku gjatë një ore të hapur u diskutua gjerësisht mbi fushën e sigurimeve dhe rolin që ajo luan në ekonominë moderne. Nxënësit u informuan mbi mundësitë e shumta të zhvillimit profesional në këtë sektor, si dhe mbi vlerat dhe standardet që ALBSIG përfaqëson në treg. Krahas prezantimit teorik, ALBSIG ka mundësuar edhe trajnim praktik për nxënësit e kësaj shkolle në degët e saj, duke u ofruar atyre një eksperiencë reale mbi proceset e punës, ndërveprimin me klientët dhe detyrat e përditshme që karakterizojnë aktivitetin e një kompanie sigurimesh. Kjo iniciativë përbën një kontribut të drejtpërdrejtë në ndërtimin e kompetencave profesionale të të rinjve.



Studentët e Universitetit Epoka vizitojnë Departamentin e Marketingut të ALBSIG

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm u zhvillua me studentët e degës Marketing pranë Universitetit Epoka, të cilët në kuadër të projektit të tyre për studimin e tregut zgjodhën ALBSIG për të marrë një pasqyrë konkrete dhe profesionale mbi funksionimin e marketingut në industrinë e sigurimeve. Ekipi i Marketingut të ALBSIG i mirëpriti me kënaqësi studentët, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre dhe duke i prezantuar me praktikatat më të mira të komunikimit, ndërtimit të strategjive promovuese në një treg dinamik dhe konkurrues. Kjo vizitë u shndërrua në një eksperiencë frymëzuese që ndërthur dijen teorike me praktikën, si dhe kuriozitetin me vizionin për një të ardhme të sigurt profesionale.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, ALBSIG riafirmon angazhimin e saj për të investuar në edukimin dhe zhvillimin e të rinjve, duke kontribuar në krijimin e një kulture të qëndrueshme sigurimesh në vend. Shoqëria mbetet e palëkundur në misionin e saj për të ndarë njohuri, për të ofruar mbështetje dhe për të mbështetur talentet e reja që do të jenë profesionistët e së nesërme.



4.14. ALBSIG mbështet projektin kinematografik “Kazerma” Një standard i ri në kinematografinë moderne shqiptare

Në kuadër të përgjegjësisë së saj korporative dhe angazhimit të vazhdueshëm në mbështetje të artit, kulturës dhe talenteve shqiptare, ALBSIG ka nderin të jetë një nga mbështetësit kryesorë të projektit kinematografik “Kazerma”, prodhim i regjisorit dhe producentit Turjan Hysko. Ky projekt cilësohet si një nga prodhimet më inovative dhe më të realizuara të kinemasë moderne shqiptare, duke sjellë një qasje të re artistike dhe një standard të lartë profesional në industrinë e filmit.

Mbështetja e ALBSIG për “Kazermën” shprehet si një investim i drejtpërdrejtë në zhvillimin e artit shqiptar dhe në promovimin e vlerave kulturore që ndikojnë pozitivisht në shoqëri. Si një kompani e përkushtuar ndaj rritjes dhe progresit, ALBSIG beson fuqishëm se arti dhe kinematografia përbëjnë shtylla të rëndësishme për emancipimin kulturor, mbështetjen e të rinjve dhe forcimin e identitetit kombëtar. Duke vlerësuar vizionin dhe profesionalizmin e ekipit realizues, ALBSIG ka zgjedhur të kontribuojë në këtë projekt si një partner serioz, i besueshëm dhe afatgjatë.

Mbështetja jonë përfshin jo vetëm suport financiar, por edhe besim të palëkundur në rëndësinë e një krijimtari cilësore që i flet publikut shqiptar me narrativë bashkëkohore, mjeshtëri artistike dhe integritet profesional. ALBSIG vlerëson faktin që projekti i kalon kufijtë e një filmi argëtues, duke u shndërruar në një produkt kulturor që ngre lart standardet e kinematografisë vendase dhe dëshmon potencialin e industrisë shqiptare për të prodhuar vepra të nivelit ndërkombëtar.

Si pjesë e strategjisë së saj për të kontribuar në komunitet, ALBSIG mbetet e përkushtuar për të mbështetur iniciativë që inspirojnë, edukojnë dhe sjellin vlerë të qëndrueshme. Bashkëpunimi me projektin “Kazerma” përfaqëson pikërisht këtë filozofi: një investim në talent, profesionalizëm dhe art që qëndron në kohë. ALBSIG do të vijojë të jetë pranë projekteve që pasurojnë jetën kulturore të vendit dhe mbështesin krijimtarinë artistike, duke besuar se përmes fuqisë së artit ndërtohet një shoqëri më e informuar, më e ndjeshme dhe më vizionare. ALBSIG — Partner i besimit për artin, kulturën dhe zhvillimin e komunitetit.

5.1 Misioni, Qëllimi dhe Objektivat Strategjike

Ky raport vjetor është përgatitur për të informuar Këshillin Mbikëqyrës, Komitetin e Auditimit dhe Administratorët e Albsig sh.a. mbi përmbushjen e planit të punës, efektivitetin e kontroleve dhe vlerën e shtuar përgjatë vitit financiar 2025. Objektivi parësor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm mbetet vlerësimi i pavarur i përputhshmërisë së veprimtarisë së Shoqërisë me kuadrin ligjor, rregullativ të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe politikat e brendshme.

Shtyllat kryesore të veprimtarisë për vitin 2025:

- **Sistemet e Kontrollit:** Monitorimi i vazhdueshëm dhe forcimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm në të gjitha departamentet.
- **Integriteti i të Dhënave:** Sigurimi i saktësisë, besueshmërisë dhe plotësisë së informacionit financiar dhe operacional.
- **Efikasiteti i Burimeve:** Vlerësimi i përdorimit optimal të burimeve njerëzore, teknologjike dhe financiare të Shoqërisë.
- **Menaxhimi i Risqeve:** Identifikimi proaktiv i rreziqeve operationale dhe vlerësimi i strategjive për zbutjen e tyre.

Stabiliteti Rregullativ: Gjatë vitit 2025, korniza e brendshme rregullatore ka treguar qëndrueshmëri të lartë, duke mos pasur nevojë për amendime, gjë që dëshmon për një pjekuri të sistemeve ekzistuese të kontrollit.

5.2 Metodologjia, Analiza e Rrezikut dhe Plani i Punës

Veprimtaria e auditimit gjatë vitit 2025 është udhëhequr nga parimet e Kartës së Auditimit të Brendshëm dhe Vendimi i Bordit nr. 153, datë 23.12.2014. Gjithashtu, janë integruar praktikat më të mira ndërkombëtare të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Audituesve të Brendshëm (IIA).

Qasje e bazuar te rreziku

Hartimi i Planit Vjetor të Auditimit 2025 u mbështet mbi një analizë të matricës së rreziqeve dhe mbi "oreksin ndaj rrezikut" të përcaktuar në planin e biznesit të Shoqërisë. Kjo mundësoi fokusimin e burimeve në fushat me ekspozim më të lartë kritik.

- **Përmbushja e Planit:** Njësia ka realizuar pothuajse të gjithë listën e angazhimeve të planifikuara për vitin 2025.
- **Raportimi i Gjetjeve:** Për çdo angazhim është hartuar një raport formal, i cili përfshin planet e dakordësuara të veprimit me menaxhimin dhe afatet specifike të zbatimit.

5.3 Deklarata e Pavarësisë

Në përputhje me standardet më të larta të qeverisjes së korporatës, Njësia e Auditimit të Brendshëm konfirmon se gjatë vitit ushtrimor 2025 ka gëzuar pavarësi të plotë institucionale dhe profesionale.

- **Pa Ndërhyrje:** Nuk është regjistruar asnjë ndërhyrje e jashtme në përcaktimin e fushëveprimit, metodologjisë, apo në formulimin e opinionëve të auditimit.
- **Pa Konflikt Interesi:** Audituesit nuk kanë pasur asnjë përgjegjësi operative apo menaxheriale në proceset e audituara, duke garantuar paanësi absolute në gjykimet profesionale.
- **Kodi i Etikës:** I gjithë personeli ka vepruar në përputhje me parimet e integritetit, fshehtësisë dhe kompetencës profesionale.

5.4 Struktura Organizative, Raportimi dhe Zhvillimi Profesional

Për të garantuar objektivitetin, funksioni i Auditimit të Brendshëm mban një linjë të dyfishtë raportimi: raportim funksional te strukturat e pavarura të mbikëqyrjes dhe raportim administrativ te menaxhimi i lartë.

Kokretisht, funksioni i Auditimit të Brendshëm, në përputhje me organizimin e Shoqërisë, raporton në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejtë tek:

- Komiteti i Auditimit;
- Këshilli Mbikëqyrës;
- Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Ngritja e Kapaciteteve 2025

Me qëllim përshtatjen me inovacionin dhe mjedisin digjital në rritje të Albsig sh.a, stafi i auditimit ka ndjekur trajnime të dedikuara në fushën e auditimit të sistemeve të informacionit (IT Audit), menaxhimit të rreziqeve kibernetike dhe teknikave të ndryshme të analizës së të dhënave. Gjithashtu, në kuadër të adresimit të kërkesave të reja ligjore sa i përket Të dhënave Personale, stafi i Auditimit të Brendshëm është informuar dhe trajnuar rregullisht nga strukturat përkatëse brenda dhe jashtë shoqërisë.

5.5 Opinioni i Audituesit të Brendshëm (Viti Financiar 2025)

Në përfundim të ciklit të auditimit për vitin 2025, bazuar në punën e kryer dhe provat e grumbulluara, ofrohet një siguri e arsyeshme se korniza e kontrollit të brendshëm, qeverisjes dhe menaxhimit të rreziqeve në shoqërinë Albsig sh.a. është e mirëstrukturuar dhe funksionale.

Konstatimet Kryesore:

- ✓ **Nivel i Kënaqshëm Kontrolli:** Pjesa më e madhe e proceseve të analizuara janë klasifikuar në nivelet “Kënaqshëm”, ndërsa për proceset e vlerësuara me “Ka nevojë për përmirësim” janë hartuar plane korrigjuese të menjëhershme.
- ✓ **Nuk ka Gjetje Kritike:** Gjatë vitit 2025 nuk janë konstatuar mangësi kritike, anomali materiale apo rreziqe të jashtëzakonshme që mund të cenojnë stabilitetin financiar apo reputacionin e Shoqërisë.
- ✓ **Profil Risku i Ulët/Mesatar:** Rreziqet e mbetura janë mbajtur brenda kufijve të pranueshëm të Shoqërisë. Rekomandimet e dhëna janë fokusuar në optimizimin e mëtejshëm të procedurave operacionale dhe dokumentimit të proceseve.
- ✓ **Gjurmimi i Rekomandimeve:** Njësia ka kryer monitorim periodik të zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, duke vërejtur një angazhim të lartë të menaxhimit për zbatimin e tyre në kohë.

Përfundim institucional: Strukturat e qeverisjes korporative të Albsig sh.a. ofrojnë mbështetjen e nevojshme për arritjen e qëndrueshme të objektivave strategjike dhe mbrojtjen e interesave të aksionarëve dhe klientëve tanë.

Auditimi i Brendshëm
Suela POPA

Menaxhimi i riskut është një balancim i elementeve të ndërthurur që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe kërkojnë efektivitet të vazhdueshëm në ekuilibër me njëri-tjetrin. Risqet e veçanta nuk mund të adresohen të izoluar, menaxhimi i një risku mund të ketë ndikim mbi një risk tjetër, ndërsa veprimet e menaxhimit që kontrollojnë më shumë se një risk njëkohësisht e bëjnë të vështirë arritjen e të gjitha objektivave në të njëjtën kohë. Standardi përcakton tiparet e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut në nivel të lartë. Kërkesat e mëtejshme dhe udhëzimet në lidhje me to janë të mbuluara në seksionet e tjera të standardeve dhe udhëzimeve të paraqitura në Tabelën 2 më poshtë:

Subjekti	Referenca në standarde/udhëzime
Strategjia e riskut	SR (Plani i Menaxhimit të Riskut)
Struktura qeverisëse e riskut	SQ (Departamenti i Riskut dhe IT)
Proceset e marrjes së vendimeve	PV
Vetëvlerësimi i identifikimit të riskut	VIR ORSA
Raportimi i riskut	RR
Plani i vijueshmërisë së veprimit	PVV

6.1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm. Menaxhimi i riskut lidhet me risqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave të përcaktuar si më poshtë: Në Planin e menaxhimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria.

6.2 Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi dhe eliminimi apo reduktimi i tij në një nivel të pranueshëm, duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm, përbën bazën e sistemit të menaxhimit të riskut të Albsig Sh.a. Menaxhimi i riskut lidhet me risqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin dhe ruajtjen e vlerës. Në Planin e Menaxhimit të Riskut, identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikimin e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria gjatë vitit 2025.



Risqet identifikohen dhe kategorizohen sipas natyrës së tyre në kategorite kryesore të përcaktuara në Tabelën 3 më poshtë, duke u vlerësuar sipas pesës specifike të çdo faktori. Ky proces zhvillohet në bashkëpunim me drejtuesit dhe punonjësit përgjegjës të çdo departamenti, duke siguruar një pasqyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të profilit të riskut të shoqërisë:

Nr	Kategoritë/ faktorët e riskut	Pesha specifike për cdo factor
1	Reputacioni (R)	30%
2	Përputhshmëria (P)	30%
3	Operacionali (O)	20%
4	Financiar (F)	20%

6.3 Kornizimi i riskut i shoqërisë Albsig Sh.a

Shoqëria Albsig Sh.a. fokusohet tek risqet kryesore të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike. Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut, i cili mbulon si risqet strategjike ashtu edhe ato që lidhen me veprimtarinë e përditshme operative.

Gjatë vitit 2025, shoqëria ka identifikuar risqet kryesore dhe ka orientuar skenarët e stresit si më poshtë:

- Risku i sigurimit
- Risku i kredisë
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit
- Risku operacional
- Risku strategjik

Këto janë risqet kryesore që mund të kërcënojnë objektivat strategjike të shoqërisë. Përveç tyre, janë identifikuar dhe risqe shtesë që monitorohen vazhdimisht:

- Risku i këmbimit të monedhës së huaj
- Risku reputacional
- Risku i çmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në veçanti MTPL.

Të gjitha risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara në seksionet në vijim.

Risku i Kreditit

Risku i kredisë i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare për shoqërinë. Në rrjedhën normale të aktivitetit, kur pranohen primet, fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve. Shoqëria Albsig Sh.a. është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë nga fondet e mbajtura, depozitat bankare dhe risiguruesit. Për të administruar këtë ekspozim, shoqëria ka vendosur procedura të brendshme të monitorimit, si dhe respekton kërkesat ligjore në fuqi, sipas të cilave risiguruesit duhet të kenë klasifikime minimale (BB) ose norma më të larta. Monitorimi i vazhdueshëm i riskut të kredisë kryhet nga personeli i departamentit të risigurimit.

Gjatë vitit 2025, shoqëria ka vijuar administrimin e ekspozimit ndaj riskut të kredisë nëpërmjet monitorimit të instrumenteve të borxhit dhe depozitave, duke siguruar që çdo vendim investimi të jetë në përputhje me politikën e miratuar të investimeve dhe limiteve të ekspozimit.

31 dhjetor 2025	A+	A	A-	AA	AA-	AA+	BB	Pa normë	Totali
në '000 Lekë									
Aktivet Financiare									
Investimet								2,144,028	2,144,028
Aktive të lidhura me risigurimin	9,633	14,723	650	1,906	67,275	-	2,011	-	96,198
Llogari të arkëtueshme								191,736	191,736
Aktive të tjera								71,781	71,781
Mjete monetare në arkë dhe bankë								105,866	105,866
31 dhjetor 2024	A+	A	A-	AA	AA-	AA+	BB	Pa normë	Totali
në '000 Lekë									
Aktivet Financiare									
Investimet								2,144,028	2,144,028
Aktive të lidhura me risigurimin	8,213	13,335	556	-	31,888	-	436	-	54,428

Llogari të arkëueshme								191,736	191,736
Aktive të tjera								71,781	71,781
Mjete monetare në arkë dhe bankë								105,866	105,866

Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2025				2024			
	Primet e ceduara		Aktive të risigurimit		Primet e ceduara		Aktive të risigurimit	
	'000 Lek	% ndaj totalit	'000Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit
Norma								
AA	6,117	2.3%	1,906	2.0%	-	0.0%	-	0.0%
A+	28,062	10.5%	9,633	10.0%	31,142	14.6%	8,213	15.1%
A	41,810	15.6%	14,723	15.3%	41,846	19.7%	13,335	24.5%
A-	3,123	1.2%	650	0.7%	2,800	1.3%	556	1.0%
AA-	183,642	68.7%	67,275	69.9%	135,591	63.7%	31,888	58.6%
AA+	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%
AAA	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%
BBB	4,635	1.7%	2,011	2.1%	1,449	0.7%	436	0.8%
Pa norme	-	0.0%	-	0.0%		0.0%	-	0.0%
Totali	267,389	100%	96,198	100%	212,828	100%	54,428	100.0%

Risku i Tregut

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare, e thelluar nga pasiguritë gjeopolitike dhe luhatjet e normave të interesit, paraqiti sfida për portofolin e investimeve gjatë vitit 2025. Shoqëria Albsig Sh.a. aplikoi strategji të diversifikimit të investimeve, protokolle të testimit të stresit dhe mekanizma mbrojtës për t'u mbrojtur ndaj lëvizjeve të tregut, duke ruajtur kthimin e investimeve dhe raportet e likuiditetit brenda kufijve të përcaktuar nga rregullatori.

Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorët e mëposhtëm:

- **Normat e interesit** – luhatjet e normave ndikojnë drejtpërdrejt në vlerën e portofolit të investimeve dhe në koston e detyrimeve;
- **Kurset e këmbimit** – ekspozimi ndaj monedhave të huaja, kryesisht EUR dhe USD, mund të ndikojë në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve;
- **Ecuria ekonomike** – faktorët makroekonomikë ndikojnë në performancën e përgjithshme të tregut dhe në kthimin e investimeve;
- **Portofoli i investimeve** – risku i humbjeve nga luhatjet e çmimeve të instrumenteve financiare.

Shoqëria monitoron vazhdimisht ekspozimin ndaj riskut të tregut dhe ndërmerr masa korrigjuese kur ekspozimi tejkalon kufijtë e tolerancës së miratuar.

Risku i sigurimit

Konkurrenca në rritje dhe dinamika e ndryshueshme e tregut kanë kërkuar rishikimin dhe përmirësimin e strategjive të nënshkrimit. Shoqëria përdor analiza të avancuara të të dhënave dhe procese të automatizuara për të përmirësuar saktësinë në vlerësimin e riskut, për të lehtësuar identifikimin e risqeve potenciale dhe për të mbështetur vendimmarrjen në procesin e nënshkrimit.

Shoqëria administron riskun përmes politikave të nënshkrimit dhe risigurimit, të mbështetura nga struktura të përshtatshme të menaxhimit të riskut. Çmimi i produkteve përcaktohet duke marrë në konsideratë eksperiencën historike, karakteristikat e portofolit dhe profilin e riskut. Ekspozimet kryesore lidhen me sigurimin e pasurisë, sigurimin financiar dhe sigurimin e automjeteve, me maturitete që shtrihen deri në 12 muaj. Risqet kryesore përfshijnë fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe ngjarje të tjera me frekuencë të ulët, por me ndikim potencial në rezultatet e shoqërisë. Shoqëria vlerëson se politikat e nënshkrimit, struktura e risigurimit dhe pozicioni financiar aktual ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për përballimin e ekspozimeve të identifikuara.

6.4 Dëmet në shoqërinë Albsig Sh.a.

Shpenzimet për trajtimin e dëmeve gjatë vitit 2025 janë në vlerën 58,860,345 lekë (2024: 65,875,874 lekë).Ne tabelen 9 jepet historiku i dëmeve të paguara bruto nga Shoqëria Albsig sh.a. përsa i përket kohës së pagesës së dëmeve është si më poshtë.

Në mijë Lek	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Grand Total
At the end of the accident year	133,786,131	211,648,744	426,411,978	551,493,443	328,822,389	512,852,876	456,838,279	885,832,351	748,937,598	811,304,157	5,067,927,946
1 year later	76,248,560	138,350,218	140,860,351	1,226,165,384	107,003,879	155,985,298	183,700,979	339,800,098	257,396,023		2,625,510,790
2 years later	40,542,902	22,928,797	34,887,568	197,022,281	26,611,368	47,277,423	48,344,866	34,358,043			451,973,248
3 years later	15,060,369	10,237,043	8,278,601	100,878,741	15,280,836	53,920,656	12063560.67				215,719,807
4 years later	80,193,640	4,344,516	18,962,559	86,779,520	7,585,216	14134416.4					211,999,867
5 years later	251311.69	23,403,776	2,799,354	13,235,040							39,689,482
6 years later	4800292.24	239,990	71,803								5,112,085
7 years later	687,728	326,590	326,590								1,340,908
8 years later		503,620									503,620
9 years later											
Accumulated	351,570,934	411,983,294	632,598,804	2,175,574,409	485,303,688	784,170,669	700,947,685	1,259,990,492	1,006,333,621	811,304,157	8,619,777,753

Risku i Administrimit të kapitalit

Strategjia e Shoqërisë në lidhje me menaxhimin e kapitalit ka mbetur e pandryshuar gjatë periudhës raportuese. Struktura e kapitalit përbëhet nga kapitali aksionar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Shoqëria monitoron vazhdimisht pozicionin e kapitalit për të siguruar ruajtjen e niveleve të përshtatshme të kapitalizimit, përmbushjen e kërkesave rregullore dhe mbështetjen e objektivave të saj strategjike.

Menaxhimi i kapitalit synon ruajtjen e aftësisë së Shoqërisë për të vijuar aktivitetin në mënyrë të qëndrueshme, duke siguruar përmbushjen e detyrimeve dhe optimizimin e përdorimit të burimeve të kapitalit. Më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024, kapitali aksionar i Shoqërisë rezulton në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullore të zbatueshme për sektorin e sigurimeve, duke garantuar një bazë të qëndrueshme për vijimësinë e aktivitetit.

Risku i Reputacionit

Risku reputacional mbetet një element i rëndësishëm për Shoqërinë, veçanërisht në një mjedis me ekspozim të lartë mediatik dhe përdorim të gjerë të platformave sociale. Menaxhimi i këtij risku realizohet përmes komunikimit transparent, trajtimit në kohë të ankesave dhe monitorimit të vazhdueshëm të perceptimit të palëve të interesuara, me qëllim ruajtjen e reputacionit dhe forcimin e besimit të klientëve.

Risku ligjor

Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator në segmentet ku operon Shoqëria mund të ndikojnë në aktivitetin dhe rezultatet financiare të saj. Sektori i sigurimeve në Shqipëri është subjekt i një mjedisi rregullator dinamik dhe të mbikëqyrur vazhdimisht, me fokus kryesor mbrojtjen e të siguruarve dhe forcimin e stabilitetit të tregut. Për menaxhimin e këtij ekspozimi, Shoqëria monitoron në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet ligjore dhe rregullatore, duke siguruar zbatimin në kohë të kërkesave të reja dhe përshtatjen e proceseve të brendshme. Gjithashtu, ruhet një angazhim i vazhdueshëm me autoritetet mbikëqyrëse dhe palët përkatëse, me qëllim identifikimin e hershëm të ndryshimeve potenciale dhe reduktimin e riskut të mospërputhshmërisë. Kjo qasje kontribuon në forcimin e kulturës së përputhshmërisë dhe mbështet menaxhimin efektiv të riskut rregullator.

Risku Klimatik dhe Katastrofik

Rritja e frekuencës dhe rëndësisë së katastrofave natyrore nënvizoi urgjencën e menaxhimit të rrezikut klimatik. Siguruesit integruan vlerësimet e riskut klimatik në vendimet e nënshkrimit dhe investimeve, duke bashkepunuar për modelimin e saktë dhe duke promovuar iniciativat e qëndrueshme për të zbutur risqet e lidhura me klimën, duke siguruar reziliencë afatgjatë përpara sfidave mjedisore.

Risku nga kurset e këmbimit

Risku i normës së interesit lidhet me mundësinë e ndryshimeve në vlerën e instrumenteve financiare si rezultat i luhatjeve në normat e interesit të tregut, si dhe me mospërputhjet e mundshme ndërmjet maturiteteve të aktiveve dhe detyrimeve të lidhura me to. Niveli i ekspozimit ndaj këtij risku varet nga periudha gjatë së cilës normat e interesit mbeten të fiksuara për instrumentet financiare përkatëse.

Aktivet dhe pasivet e Shoqërisë mbartin norma interesi të përcaktuara sipas kushteve të tregut. Shoqëria mban një nivel të kufizuar të detyrimeve interes mbartëse, për rrjedhojë ekspozimi ndaj rritjeve të normave të interesit dhe ndikimi i mundshëm në kosto konsiderohet jo material. Nga ana tjetër, aktivet interes mbartëse karakterizohen kryesisht nga norma interesi fikse, duke kufizuar ndikimin e luhatjeve afatshkurtra të tregut. Gjithashtu, aktiviteti i Shoqërisë përfshin ekspozime në tre valuta kryesore, përkatësisht LEK, EUR dhe USD, duke krijuar ekspozim ndaj riskut valutor. Tabela e mëposhtme paraqet analizën sasiore të ekspozimit valutor të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2025 dhe 2024:

		2025	2024
	Ndikimi	në Lek	në Lek
EUR rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	29,085,067	1,064,468
EUR ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	(29,085,067)	(1,064,468)
USD rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	7,581,865	8,072,248
USD ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	(7,581,865)	(8,072,248)

Risku Operacional

Risku operacional lidhet me mundësinë e humbjeve që mund të vijnë si rezultat i proceseve të brendshme joefektive, gabimeve njerëzore, sistemeve teknologjike, ngjarjeve të jashtme ose ndërprerjeve në aktivitetin e Shoqërisë. Kërcënimet e sigurisë kibernetike kanë vijuar të rriten në kompleksitet, duke krijuar ekspozime shtesë për aktivitetin operacional. Për menaxhimin e këtij risku, Shoqëria ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës së sigurisë, forcimin e kontroleve të brendshme, monitorimin e vazhdueshëm të sistemeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve për çështjet e sigurisë së informacionit. Përdorimi i sistemeve të shitjes, administrimit, trajtimit të dëmeve dhe financës ka kontribuar në rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e proceseve të kontrollit, raportimit dhe monitorimit të riskut.

Shoqëria vijon të aplikojë analiza aktuariale për vlerësimin e provigjoneve teknike, duke përdorur metoda të përshtatshme për llogaritjen e dëmeve të raportuara (RBNS) dhe dëmeve të ndodhura por të paraportuara (IBNR). Vëmendje e veçantë i kushtohet segmenteve me luhatje më të larta në vlerësim, veçanërisht dëmeve të sigurimit motorik dhe shëndetësor.

Për sigurimin e raportimit të saktë dhe përditësimit të informacionit, Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik, Menaxhimin e Riskut dhe Departamentin IT, duke siguruar trajtimin dhe azhurnimin e vazhdueshëm të rasteve të dëmeve dhe proceseve gjyqësore në përputhje me procedurat e brendshme dhe kërkesat rregullatore. Testimi i provigjoneve të dëmeve realizohet nëpërmjet analizave RUN-OFF, duke përfshirë vlerësimin e dëmeve të raportuara (RBNS) dhe dëmeve të ndodhura por të paraportuara (IBNR). Gjatë periudhave të monitorimit janë kryer teste të vazhdueshme për sigurimet motorike TPL, Kartonin Jeshil, Kufitare dhe Kasko, të cilat kanë rezultuar pozitive dhe kanë mbështetur nivelin e provigjoneve teknike të Shoqërisë.

Risku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti. Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një). Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit dhe është më i lartë se 1 (një).

6.5 Kuadri i Administrimit të Riskut

Shoqëria Albsig Sh.a. mbikëqyrret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore. Albsig Sh.a. ka vendosur objektiva të qarta për periudhën 1-vjecare dhe 3-vjecare dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave.

Kjo kërkon vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të riskut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj risqeve me të cilat përballen shoqëria. Këtu merr kuptim Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e risqeve, por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut. Çdo njësi e qeverisjes duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të paktën një herë në vit) si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.



6.6 Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë. Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregullatore në çdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e risqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së siguruar, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2025 vlera e fondit të garancisë është brenda të gjitha normave të kërkuara ligjore.

6.7 Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" si dhe rregullores nr. 19 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" aktivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 gusht 2008. ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 Dhjetor 2025:

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt
I.	Aktivet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		4,224,246,502
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	19,354,000
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	122,000,000
I.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose sigurorese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë;	10%	54,802,451
I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14:	30%	1,832,252,027
	Qëllime shfrytëzimi		1,832,252,027
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	2,195,838,025
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	130,312,818
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	97,672,306
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%	
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risigurorese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjonit të primit të pafitur;	20%	343,932,099
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	218,851,596
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	83,253,325
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit jeshil pranë BSHS	100%	6,054,173
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	1,084,325,163
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		6,188,647,982
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		5,111,496,412

VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		4,540,777,900
VI.1	Provigjone të primit të pafituar		3,181,281,668
VI.2	Provigjone të dëmeve		1,359,496,232
VII	Tepricë (+) / Mungesë (-) (V-VI)		570,718,512
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		112.57%

6.8 Marzhi i Aftësisë Paguese

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbejnë atë" koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maxmale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b1 = koeficienti i pasigurisë, duke marrë në konsideratë shumën "a" është 0.18

b2 = koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë në konsideratë "a2" është 0.16

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2025 është brenda limiteve të kërkuara.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

	Kufiri minimal i Aftësisë paguese, Jo Jete	ALBSIG SH.A.	31.12.2025
1	Llogaritja me baze primet		
2	Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve	4,705,871,264	lekë
3	Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve	-	lekë
4	Taksa të zbritshme	249,219,437	lekë
5	Shuma "a" (5=2+3-4)	4,456,651,827	lekë
6	Pjesa e shumës "a" me e vogël se 1,000,000,000 leke (6=min(1,000,000,000,5))	1,000,000,000	lekë
7	Pjesa e shumës "a" me e madhe se 1,000,000,000 leke (7=5-6)	3,456,651,827	lekë
8	Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)	0.18	
9	Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)	0.16	
10	Total (10=6*8+7*9)	733,064,292	lekë
11	Deme të paguara bruto	1,189,698,695	lekë
12	Pjesa e risiguruesit në demet e paguara	8,771,277	lekë
13	Deme të paguara neto (13=11-12)	1,180,927,418	lekë
14	provigjone bruto të dëmeve në periudhën aktuale	1,359,496,233	lekë
15	provigjone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar	1,084,705,704	lekë
16	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në periudhën aktuale	19,354,000	lekë
17	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në fund të vitit të kaluar	-	lekë
18	provigjone neto të dëmeve në periudhën aktuale (18=14-16)	1,340,142,233	lekë
19	provigjone neto të dëmeve në fund të vitit të kaluar (19=15-17)	1,084,705,704	lekë

20	ndryshimi ne provigjonet e demeve bruto (20=14-15)	274,790,529	lekë
21	ndryshimi ne provigjonet neto te demeve (21=18-19)	255,436,529	lekë
22	Deme te ndodhura bruto (22=11+20)	1,464,489,224	lekë
23	Deme te ndodhura neto (23=21+13)	1,436,363,947	lekë
24	Raporti i mbajtjes (24=max(0.5 , 23/22))	0.9808	
25	Rezultati nga llogaritja me baze primet (25=24*10)	718,989,458	lekë
26	2. Llogaritja me baze demet		
27	deme te paguara bruto ne vitin e pare	1,303,485,215	lekë
28	pjesa e risiguruesit ne demet e paguara ne vitin e pare	332,129,511	lekë
29	deme te paguara neto ne vitin e pare (29=27-28)	971,355,704	lekë
30	deme te paguara bruto ne vitin e dyte	1,275,022,313	lekë
31	pjesa e risiguruesit ne demet e paguara ne vitin e dyte	141,741,948	lekë
32	deme te paguara neto ne vitin e dyte (32=30-31)	1,133,280,364	lekë
33	deme te paguara bruto ne vitin e trete	1,189,698,695	lekë
34	pjesa e risiguruesit ne demet e paguara ne vitin e trete	8,771,277	lekë
35	deme te paguara neto ne vitin e trete (35=33-34)	1,180,927,418	lekë
36	provigjone bruto te demeve ne fund te vitit te pare	820,650,324	lekë
37	provigjone neto te demeve ne fund te vitit te pare	775,081,874	lekë
38	Totali i demeve te ndodhura (38=27+30+33-36+14)	4,307,052,132	lekë
39	Shuma "b" deme te ndodhura/3 (39=38/3)	1,435,684,044	lekë
40	Pjesa e shumes "b" me e vogel se 750,000,000 leke (40=min (750,000,000, 39))	750,000,000	lekë
41	Pjesa e shumes "b" me e madhe se 750,000,000 leke (41=39-40)	685,684,044	lekë
42	koeficienti i pasigurise b1 (42=0.26)	0.26	
43	koeficienti i pasigurise b2 (43=0.23)	0.23	
44	Total (44= (40*42) + (41*43))	352,707,330	lekë
45	totali i deme te ndodhura bruto (45=38)	4,307,052,132	lekë
46	totali i deme te ndodhura neto (46=29+32+35-37+18)	3,850,623,845	lekë
47	raporti i mbajtjes (47=max(0.50, 46/45))	0.89	
48	Rezultati nga llogaritja me baze demet:(48=44*47)	313,909,524	lekë
49	Kufiri minimal i Aftesise Pagueuse (49= max(48,25))	718,989,458	lekë

Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2025 përbëhet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	2,272,614,263
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	879,460,000

I.c	Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	1,396,265,462
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	3,111,200
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	-
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	764,763,405
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	432,254,000
IV.b	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën "a", të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës	
V	Aktivet jolikuide (V.a deri V.g)	332,509,405
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	54,802,451
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90- ditor;	178,631,368
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	91,867,214
V.h	Elemente të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10) :	7,208,372
V.h-9	Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil	6,054,173
V.h-10	Çdo zë tjetër në kundërshtim me kërkesat ligjore, rregullatore dhe vendime të Bordit të Autoritetit	1,154,199
V.h-9	Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil	6,140,509
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	1,507,850,858
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	718,989,458
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	1,078,484,187
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	429,366,671
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

6.9 Testi i rezultateve të marrjes në sigurim

Duke u bazuar në një analizë 3-vjecare 2023-2025 dhe tek testi i rezultateve të marrjes në sigurim sipas portofoleve si më poshtë për vitin 2025:

- **Portofoli i Aksidenteve dhe shëndeteve** evidenton nivel të pandryshuar të raportit dëme/prime neto për periudhën 2024—2025, pa lëvizje të ndjeshme midis dy viteve. Monitorimi i kujdesshëm i raportit të shpenzimeve, veçanërisht i komponentit të marrjes në sigurim, do të vazhdojë nga menaxherët përkatës me qëllim normalizimin e tij.
- **Produkti Kasko** është në përgjithësi produkt me nivel të lartë risku dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe menaxhim të kujdesshëm. Është informuar menaxheri i këtij produkti për të kryer monitorim më të detajuar, me qëllim që raporti në të gjithë elementët përbërës të tij të mbahet nën kontroll dhe të mos rezultojë me humbje. Për këtë produkt janë kryer analiza të vazhdueshme gjatë vitit, si analiza në nivel total të produktit ashtu edhe në nivel të subjekteve të siguruar. Si rezultat i monitorimit dhe analizave të vazhdueshme, ky produkt ka paraqitur përmirësim në performancë. Produkti Kasko ka raport të kombinuar me ulje në krahasim me vitin 2024.
- **Sigurimi i detyrueshëm motorik** monitorohet përsa l përket komisioneve të ndërmjetësimit që të jenë në përputhje me kërkesat e rregullores në fuqi. Raporti dëme / prime neto për vitin 2025 ka patur rritje krahasuar me 2024. **Edhe për sigurimin e detyrueshëm motorik u është rekomanduar menaxherëve të marrjes në sigurim të këtyre produkteve që ta monitorojnë me kujdes raportin e shpenzimeve, veçanërisht të marrjes në sigurim që të vijë në normat e lejuara.**

- **Portofoli i Pronës** (Zjarr dhe rreziqe shtesë, Mall gjatë transportit, Vjedhja, Sigurimi inxhinierik, Garancitë) nga analiza rezulton që e ka tepër të lartë raportin e shpenzimeve jashtë diapazonit normal, por me ulje krahasuar me vitin 2024. Për këtë arsye ky raport vazhdon të monitorohet me kujdes nga menaxherët e marrjes në sigurim që të jetë në normat e duhura.
- **Sigurimi i Përgjegjësiwe Civile** nga analiza rezulton që e ka tepër të lartë raportin e shpenzimeve jashtë diapazonit normal por ka ulje në krahasim me vitin 2024. Për këtë arsye, ky raport vazhdon të monitorohet me kujdes nga menaxherët e marrjes në sigurim që të jetë në normat e duhura.

Përfundime:

Testet dhe rezultatet sipas linjave të sigurimit janë monitoruar në mënyrë periodike dhe kanë treguar një performancë të qëndrueshme gjatë periudhës së analizuar. Në total, raporti dëm/prim neto rezulton 31% në vitin 2023, 34% në vitin 2024 e 2025 duke mbetur në nivele të kontrolluara. Gjithashtu, raporti i shpenzimeve rezulton 60% në vitin 2023 dhe 57% në vitet 2024 dhe 2025, duke ruajtur stabilitet krahasuar me periudhën paraardhëse. Raporti i kombinuar rezulton 91% në vitin 2024 dhe 92% në vitin 2025, duke paraqitur një rritje të lehtë, pa ndryshime domethënëse në performancën e përgjithshme.

6.10. Toleranca dhe kufijtë e riskut

Toleranca ndaj riskut përcaktohet në përputhje me objektivat strategjike të Shoqërisë, të cilët lidhen kryesisht me rritjen e pjesës së tregut, arritjen e niveleve të synuara të fitimit dhe ruajtjen e një niveli kapitali të përshtatshëm. Objektivat strategjike përfshijnë gjithashtu pozicionimin e Shoqërisë në treg dhe ruajtjen e standardeve të cilësisë së shërbimit. Matja dhe monitorimi i nivelit të riskut realizohen nëpërmjet kufijve të përcaktuar gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu edhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit.

Për këtë qëllim, Shoqëria disponon manuale dhe procedura të brendshme të hartuara për menaxhimin dhe kontrollin e ekspozimeve ndaj riskut. Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi Treaty dhe Fakultative, të cilat shërbejnë si mekanizma mbrojtës për kapitalin dhe reduktimin e ekspozimeve. Ndër risqet kryesore të vlerësuara nga pikëpamja sasiore, risku i katastrofave konsiderohet një nga ekspozimet më të rëndësishme, ndaj të cilit aplikohen strategji të ndryshme zbutëse.

Gjithashtu, Shoqëria vijon procesin e rishikimit dhe përmirësimit të politikave të menaxhimit të riskut, në përputhje me planin e menaxhimit të riskut të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Primet e biznesit të Pronës gjenerohen kryesisht nga sigurimet vullnetare dhe kanalet bankare. Menaxhimi i këtij ekspozimi realizohet kryesisht nëpërmjet risigurimit, i cili përbën mekanizmin kryesor të transferimit të riskut, veçanërisht për produktet Zjarr dhe Rreziqe Shtesë, ku ekspozimet kryesore lidhen me riskun e zjarrit dhe tërmetit. Marrëveshjet e risigurimit lidhen vetëm me shoqëri risigurimi që përmbushin kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.



6.11. Kufijtë për risigurim 2025

Në lidhjen e kontratave të risigurimit, shoqëria do të shfrytëzojë kapacitetin e konsiderueshëm teknik dhe financiar. Mbajtja e shoqërisë për cdo risk do të jetë brenda limiteve të përcaktuara sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi, ndërsa risiguruesit do të përzgjidhen nga tregu European dhe Botëror i risigurimeve, ku përfshihen:

- Swiss Re,
- Hannover Re,
- Scor,
- Trust Re,
- Munich Re, etj.

Përfundime:

Shëndeti financiar dhe marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit me tregun ndërkombëtar të risigurimeve i garantojnë shoqërisë Albsig Sh.a. besueshmëri të plotë në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër. Edhe këtë vit në risigurimin e Pronës, Aksidenteve, Përgjegjësisë dhe Kaskos shoqëria do të operojë nëpërmjet ndërmjetësimit të brokerit AON, që do të sjellë për shoqërinë rritje të ekspertizës përsa i përket përzgjedhjes së mbulimeve, limiteve apo risiguruesve që do të jenë pjesë e kontratave të risigurimit.

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut dhe kontrollit duhet të marrë masat e duhura sipas nevojës. Gjatë vitit 2025, shoqëria Albsig Sh.a. ka aplikuar një numër mënyrash për t'iu përgjigjur risqeve të identifikuar, duke përfshirë:

- **Transferimin e një pjese të riskut**– për shembull, duke blerë sigurim ose risigurim. Albsig Sh.a. ka vijuar politikën e saj të risigurimit me partnerë ndërkombëtarë të nivelit të lartë, duke transferuar riskun katastrofik dhe të koncentrimit.
- **Trajtimin ose zbutjen e riskut**– zvogëlimi i gjasave dhe/ose ndikimit të tij nëpërmjet kontrolleve të brendshme, procedurave operative dhe monitorimit të vazhdueshëm.
- **Pranimin ose tolerimin e nivelit aktual të riskut**– ku risku i afrohet ose është brenda kufijve të tolerancës së miratuar. Kjo qasje aplikohet kur zbutja e nivelit aktual të riskut është në disproporcione me përfitimet e pritshme.
- **Eliminimin ose përfundimin**– ndërprerjen e aktiviteteve që gjenerojnë ekspozim të papranueshëm ndaj riskut.
- **Rregullimin e niveleve të oreksit të riskut**– tolerimi i shkëlqes së përkohshme të kufijve për një kohë të shkurtër, ku arsyetimi dokumentohet plotësisht dhe miratohet nga menaxhmenti.

Kur përcaktohet përshtatshmëria e përgjigjeve ndaj riskut, merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- **Fizibiliteti dhe kostot**– kostot direkte, indirekte dhe të mundësisë së opsioneve alternative, si dhe kostoja për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të reja
- **Aspektet cilësore**– ndikimi i mundshëm mbi riskun reputacional dhe besueshmërinë e shoqërisë
- **Kuptimi i plotë i riskut**– sigurimi që përgjigjet bazohen në analizë të plotë të komponentëve dhe shkaqeve të riskut
- **Plani i vijimësisë**– kur risqet nuk mund të kontrollohen në nivele të pranueshme, ato shmangen ose zhvillohen plane të vijimësisë së veprimtarisë.

Në programin e Administrimit të Riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballen shoqëria. Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjikë. Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut për periudhën. Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme. Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuar më poshtë.

7.1 Kontrollat e brendshme

Aktivitetet e kontrollit veprojnë në të gjitha nivelet brenda shoqërisë Albsig Sh.a. për të zbutur risqet në nivele të pranueshme. Kontrollat përfshijnë politikat, procedurat, sistemet dhe proceset e të gjithë shoqërisë. Gjatë vitit 2025, kontrollat efektive janë karakterizuar nga tiparet e mëposhtme:

- Të përshtatshme dhe në proporcion me risqet kryesore me të cilat përballen në të gjitha nivelet, duke siguruar kosto efektive në zbutjen e riskut
- Pjesë normale e veprimtarisë së përditshme, e integruar në sistemet, procedurat dhe proceset vendimmarrëse të të gjithë biznesit
- Të koordinuara në të gjithë shoqërinë, duke siguruar konsistencë dhe efektivitet ndërdepartamental
- Subjekt i vlerësimit të rregullt për të konfirmuar efektivitetin e tyre në zbutjen e risqeve kryesore
- Subjekt i një procesi të sigurimit të përgjithshëm, i cili adreson gjithashtu mjedisin më të gjerë të kontrollit

7.1.1 Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit përfshin qasjen e qeverisjes, stilin e menaxhimit, strukturën organizative dhe kulturën e gjerë brenda të cilës zhvillohen aktivitetet e kontrollit. Shoqëria Albsig Sh.a. ka ndërtuar një mjedis kontrolli të shëndetshëm, të mbështetur nga tre linjat e mbrojtjes të përshkruara në seksionin 4.3.

Kontrollet kategorizohen në dy lloje kryesore:

- **Kontrolle Parandaluese:** Zvogëlojnë gjasat e ndodhjes së një ngjarjeje risku. Përfshijnë planifikimin strategjik, autorizimin e transaksioneve dhe kontrollet e të dhënave hyrëse. Gjatë vitit 2025, shoqëria ka forcuar këto kontrolle nëpërmjet implementimit të autentifikimit me dy faktorë (2FA) dhe politikave të menaxhimit të ndryshimeve (CM).
- **Kontrolle Zbuluese:** Identifikojnë ndodhjen e ngjarjeve të riskut pasi ato kanë ndodhur dhe mundësojnë ndërhyrje korrigjuese për të kufizuar shkallën e dëmtimit. Përfshijnë alarmet e përjashtimit, raportimin dhe shqyrtimet e rezultateve aktuale kundrejt pritjeve.

7.1.2 Vlerësimi i Efektivitetit të Kontrolleve

Vlerësimi i riskut merr në konsideratë efektivitetin e kontrolleve në zbutjen e riskut nëpërmjet dy dimensioneve:

- **Dizajni** - si duhet të funksionojë kontrolli nëse zbatohet gjithmonë në mënyrën e synuar;
- **Performanca** - mënyra në të cilën kontrolli është operuar në praktikë, nëse është aplikuar kur duhet dhe në mënyrën e synuar nga projektuesit e tij.

7.2. Ngritja e reputacionit për të zgjeruar bazën konkurruese.

Shoqëria Albsig Sh.a. përzgjedh dhe monitoron me kujdes të gjithë stafin e saj që është në kontakt me klientët, për të kënaqur pritshmëritë e klientëve në të gjitha linjat e biznesit ku shoqëria operon. Kontaktet e para me klientët janë shumë të rëndësishme dhe përbëjnë themelin e marrëdhënies afatgjatë të besimit me ta. Ky element është në përmirësim të vazhdueshëm gjatë vitit 2025, pasi ndikon drejtpërdrejt në arritjen e objektivave strategjike të shoqërisë.

Investimi në cilësinë e shërbimit ndaj klientit, trajnimin e vazhdueshëm të stafit dhe standardizimin e proceseve të komunikimit ka kontribuar në forcimin e reputacionit të Albsig Sh.a. si një nga operatorët më të besueshëm në tregun shqiptar të sigurimeve. Shoqëria i kushton fokus të veçantë risqeve kryesore reputacionale, duke monitoruar vazhdimisht kënaqësinë e klientëve, trajtimin në kohë të pretendimeve dhe ankesat. Njëkohësisht, vigjilencë e shtuar i kushtohet risqeve të tjera që mund të ndërveprojnë me risqet kryesore reputacionale, si risku operacional, risku i përputhshmërisë dhe risku i komunikimit.



Stress-testet përcaktohen përgjithësisht duke iu referuar lëvizjeve në treguesit kryesorë financiarë: – si normat e interesit, vlera e aktiveve apo vlerat e detyrimeve, ndërkohë që testet e skenarëve u referohen shkaqeve të zhvillimeve negative, si fatkeqësitë natyrore apo incidentet e mëdha industriale. Stress-testet janë të përshtatura me profilin e riskut të shoqërisë. Për këtë arsye, identifikohen risqet e mundshme afatshkurtra dhe afatgjata, ngjarjet e pritshme si dhe ndryshimet e mundshme në kushtet ekonomike që mund të kenë ndikim të pafavorshëm në gjendjen e përgjithshme financiare, me qëllim përcaktimin e efektit tek kapitali.

Analizat e skenarëve mbështeten në një gamë të gjerë ngjarjesh, duke përfshirë situatat ekstreme por realisht të mundshme, si dhe efektet materiale që mund të rrjedhin prej tyre. Stress-testet kanë patur si qëllim vlerësimin e skenarëve dhe rrethanave që do të rrezikojnë qëndrueshmërinë e modelit të biznesit, duke nxjerrë në pah dobësitë e mundshme dhe duke garantuar që shoqëria disponon kapital të mjaftueshëm për të përballuar situata të jashtëzakonshme.

Testimi i stresit të kundërt fillon nga një rezultat i modelit të biznesit dhe identifikon rrethanat në të cilat kjo mund të ndodhë. Skenarët e analizuar nga shoqëria Albsig Sh.a. janë si më poshtë:

- **Risku i sigurimit:** një tërmet apo përmbytje në zonat ku shoqëria ka ekspozim të madh ndaj tyre.
- **Risku i kredisë:** dështimi i një risiguruesi dhe/ose banke me ekspozim të lartë.
- **Risku operacional:** përzgjedhja e metodës së provigjonimit të dëmeve dhe ndikimi i diferencave me rezultatin e metodës së audituesit të pavarur, si dhe probleme me sistemin e shitjes së kontratave të sigurimit.
- **Risku i tregut:** zhvlerësim i monedhës Lekë ndaj monedhave të huaja Euro dhe Dollarë.
- **Risku i likuiditetit:** mosrinovim në masën 30% të kontratave në një nga portofolet kryesore si Prona dhe MTPL.

8.1 Vetëvlerësimi i riskut, ORSA

Orsa mund të përkufizohet si tërësia e proceseve dhe procedurave të përdorura për të identifikuar, vlerësuar, monitoruar, menaxhuar dhe raportuar në kohë afatshkurtesh dhe riskun afatgjatë. Orsa kërkon menaxhimin për të marrë parasysh vlerësimin e tyre të risqeve dhe kapitalit të shoqëruara ekonomikisht si të nevojshme për të përmbushur objektivat strategjike.

Orsa duhet të lejojë që menaxhimi të marrë një kuptim të vërtetë dhe praktik të risqeve të ekspozuar ose mund të përballë me të ardhmen, si kapitalin dhe veprimet lehtësuese të nevojshme për të mbuluar këto risqe. Si e tillë Orsa duhet të marrë parasysh proceset e riskut, kapitalit, të performancës dhe strategjisë dhe duhet të sigurojë menaxhimin me informata të nevojshme për të marrë vendime të rëndësishme në lidhje me profilin e përgjithshëm të riskut dhe kapitalit. Orsa duhet të shihet si një proces i vazhdueshëm, e jo thjesht një pikë në raportin kohor që mbulon procesin.

Qëllimi kryesor i ORSA lidhet me vlerësimin e vazhdueshëm të profilit të riskut dhe nevojave për kapital, me qëllim sigurimin e nivelit të mjaftueshëm të kapitalit për përmbushjen e detyrimeve dhe mbështetjen e objektivave strategjike të Shoqërisë.

Përcaktimi i nevojave të përgjithshme të Aftësisë Paguese kontribuon në vlerësimin nëse do të mbajë apo të transferojë risqet.

Vlerësimi i Aftësisë Paguese nevojitet që:

- Të promovojë praktikat e menaxhimit, sistemet dhe kontrollet, duke përfshirë përdorimin e teknikave të zbulimit të riskut;
- Të vlerësojë efektivitetin e proceseve dhe kontroleve, në mënyrë të veçantë për identifikimin e sistemit të self-assessment, si një nga mjetet kryesore të vlerësimit;
- Të ketë përcaktimin e bilancit me aftësinë paguese të nevojshme;
- Të përfshijë identifikimin e qartë të skenarëve të mundshëm në të ardhmen;
- Të trajtojë stresin e potencialit të jashtëm

Dhe

- Të marrë parasysh veprimet e menaxhimit të cilat mund të ndërmerren në rastin e identifikimit të dobësive.

8.2 Teste të paralajmërimit të hershëm

Bazuar në sistemin e treguesve të paralajmërimit të hershëm, është konstatuar se:

Raporti i mbajtjes neto është në masën 94.32 %.

Ky raport është pothuajse në të njëjtat nivele në krahasim me vitin 2024, duke qenë në nivelin e kufijve të lejuar.

Raporti i kombinuar për shoqërinë është në masën 91.7 %, tregues i rezultatit financiar pozitiv të shoqërisë në aktivitetin operacional

Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti dëme/prime neto për shoqërinë në 31.12.2025 është 34.45 % dhe ka rritje krahasuar me 31.12.2024 që ishte 34.31 %, sepse gjatë vitit 2025 kemi rritje të pagesave kryesisht të dëmeve TPL, Kasko dhe Pronë.

Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti i shpenzimeve në 31.12.2025 është në masën 57.26 % duke ruajtur të njëjtat nivele me vlerën e raportit në vitin 2024

Ky raport tejkalon normat e përcaktuara ndërkombëtare. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve të shoqërisë e zënë shpenzimet e marrjes në sigurim të veprimtarisë, në masën 37.06 % dhe në masën 19.80 % shpenzimet administrative të veprimtarisë së shoqërisë.

Përfundime:

Shoqëria Albsig sh.a. do të monitorojë me kujdes të madh të gjitha elementet që përbëjnë shpenzimet administrative dhe pavarësisht konkurrencës së fortë në treg për marrjen në sigurim do të monitorohen me kujdes të gjitha elementet e shpenzimeve të marrjes në sigurim..

8.3. Planet e vazhdueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara.

Plani i vijimësisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara vlerësohet nga shoqëria Albsig Sh.a. si një risk i cili duhet administruar me shumë kujdes, nisur nga varësia ndaj sistemeve të teknologjisë së informacionit. Për këtë arsye, rishikimi i planit të vijimësisë së veprimtarisë kryhet një herë në vit. Shoqëria i jep rëndësi të veçantë këtij risku, pasi në rastin e një katastrofe duhet të garantojë vazhdimësinë operacionale dhe t'u përgjigjet në kohë dhe me shpejtësi kërkesave të klientëve për dëmshpërblim.

Shoqëria ka në objektivin e saj përmirësime cilësore të mëtejshme në lidhje me sistemet e IT dhe investimet në infrastrukturën teknologjike. Monitorimi i qëndrueshëm i të gjitha fushave të riskut është thelbësor për garantimin e vijimësisë operacionale. Për këtë qëllim, shoqëria është gjithmonë e fokusuar në ndërmarrjen e masave për eliminimin ose pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm, duke siguruar që çdo ngjarje e paparashikuar të trajtohet me efektivitet dhe në kohën më të shkurtër të mundshme..

Shoqëria Albsig sh.a. gjithmonë ka një parim se menaxhimi i Riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

9.1 Opinioni i Auditorit të Jashtëm



RSM ALBANIA
Rr.Skender Luarasi, sheshi
Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Aksionerin e Shoqërisë Albsig sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë Albsig sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontablistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare individuale dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2025 priten të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një anomali materiale në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e skeduleve shoqëruese plotësuese të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("skedule plotësuese") në përputhje me Ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar skedulet plotësuese shoqëruese. Këto skedule plotësuese të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare individuale. Informacioni historik financiar, i paraqitur në skedulet shtesë të këtyre pasqyrave financiare individuale, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.



Tiranë, 20 prill 2026

9.2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e pozicionit financiar

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivitet			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	130,312,818	105,866,477
Investime	7	2,790,445,350	2,144,028,011
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	522,563,468	405,127,014
Aktive të lidhura me risigurimin	9	97,672,307	54,428,204
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	64,269,916	191,736,069
Aktive të tjera	11	88,453,922	71,780,834
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	1,084,325,163	1,206,301,804
Aktive afatgjata materiale	13	1,986,017,947	1,743,321,756
Aktive afatgjata jomateriale	14	3,111,198	3,193,627
E drejta e perdorimit të aktivitetit	15	66,239,875	65,637,762
Aktive të mbajtura për shitje	16	-	352,802,955
Aksione në shoqëri të lidhura	17	432,254,000	432,254,000
Totali i aktiveve		7,265,665,964	6,776,478,513
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	879,460,000	879,460,000
Fitime të mbartura		1,020,017,789	912,907,137
Fitimi i ushtrimit		376,247,675	307,110,659
Totali i kapitalit		2,275,725,464	2,099,477,796
Detyrimet			
Rezerva teknike për demet	19	1,359,496,232	1,084,705,703
Rezervat e primit të pafituar	20	3,181,281,669	2,888,848,176
Llogari të pagueshme për risigurimet	21	70,468,509	41,203,658
Detyrime ndaj palëve të lidhura	22	25,819,711	72,387,685
Tatim fitim i pagueshem	32	16,642,623	6,452,080
Detyrime për qera	23	67,158,334	67,587,143
Detyrime të tjera	24	269,073,422	515,816,272
Totali i detyrimeve		4,989,940,500	4,677,000,714
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		7,265,665,964	6,776,478,513

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

9.3. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Prime të shkruara bruto	23	4,705,871,264	4,313,201,807
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar	19	(292,433,493)	(148,291,935)
Të ardhura bruto nga primet e sigurimit		4,413,437,771	4,164,909,872
Prime të ceduara në risigurim	26	(267,388,966)	(212,827,509)
Ndryshimi në rezervën e primit pafituar të risiguruesit	9	23,890,102	(5,669,713)
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		4,169,938,907	3,946,412,650
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	27	30,924,741	40,912,765
Të ardhura nga interesi	28	63,243,405	60,151,184
Të ardhura të tjera		10,309,909	3,715,348
Të ardhura të tjera		104,478,055	104,779,297
Të ardhurat neto		4,274,416,962	4,051,191,947
Dëme të paguara të sigurimit	19	(1,189,698,695)	(1,275,022,312)
Dëme të paguara nga risiguruesi	19	8,771,277	141,741,948
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit	18	(274,790,529)	(212,396,485)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risigurimit	9	19,354,000	(8,300,000)
Dëme të sigurimit neto		(1,436,363,947)	(1,353,976,849)
Kostot e marrjes në sigurim	29	(1,429,177,142)	(1,462,419,881)
Shpenzimet administrative	30	(842,469,366)	(671,332,453)
Shpenzime të tjera të sigurimit	31	(112,816,265)	(107,099,896)
Shpenzime financiare neto		(43,150,106)	(92,788,713)
Total shpenzime operative		(2,427,612,879)	(2,333,640,943)
Fitim nga shitja e aktiveve materiale afatgjata, neto	13	44,773,424	4,392,804
Fitimi i vitit para tatimit		455,213,560	367,966,959
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	32	(78,965,885)	(60,856,300)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(78,965,885)	(60,856,300)
Fitimi i vitit		376,247,675	307,110,659
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		376,247,675	307,110,659

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

9.4. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital më 31 dhjetor 2025

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali i aksionar	Fitimi i mbartur	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2024	879,460,000	812,342,203	210,564,934	1,902,367,137
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	307,110,659	307,110,659
Dividente te shperndare 2023	-	(110,000,000)	-	(110,000,000)
Transferim në fitime të mbartura	-	210,564,934	(210,564,934)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	879,460,000	912,907,137	307,110,659	2,099,477,796
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	376,247,675	376,247,675
Dividente te shperndare 2024	-	(200,000,007)	-	(200,000,007)
Transferim në fitime të mbartura	-	307,110,659	(307,110,659)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2025	879,460,000	1,020,017,789	376,247,675	2,275,725,464

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 31 mars 2026 dhe janë firmosur nga:


Z. Muharrem Bardhoci
Drejtore i Përgjithshëm


Z. Irfan Lami
Drejtore i Financës

9.5. Pasqyra individuale e flukseve monetare

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e flukseve të parasë për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2025

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi neto para tatimit	455,213,559	367,966,959
Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:	-	-
Zhvlerësimi dhe amortizimi	124,823,637	53,908,551
Zhvlerësim i të arkëtushmeve	9,379,635	4,291,523
Efekti i aplikimit të SNRF 16	(1,030,922)	1,949,381
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	588,385,909	428,116,414
Ndryshimet në		
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8 (126,816,089)	(26,811,397)
Aktive të lidhura me risigurimin	9 (43,244,102)	13,969,713
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10 127,466,152	(63,762,148)
Aktive të tjera	11 (16,673,088)	7,690,355
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12 121,976,641	(14,478,921)
Rezerva teknike për demet	18 274,790,529	212,396,485
Rezervat e primit të pafitur	19 292,433,493	148,291,935
Llogari të pagueshme për risigurimet	20 29,264,851	(9,828,257)
Detyrime ndaj paleve të lidhura	21 (46,567,974)	61,142,070
Detyrime të tjera	22 (246,742,845)	683,054
Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative	954,273,477	757,409,303
Tatimi fitimi i paguar	30 (68,775,342)	(38,438,144)
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimtaria operative	885,498,135	718,971,159
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	13,15 (352,883,156)	(1,697,347,716)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	339,030,478	1,005,337,201
Blerje të aktiveve afatgjata jo-materiale	14 (781,766)	(1,507,650)
Shitje e aktiveve afatgjata jo-materiale	-	28,293
Rritja në investime	7 (646,417,339)	76,262,281
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese	(661,051,783)	(617,227,591)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese:		
Dividenti i deklaruar	(200,000,007)	(110,000,000)
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtarinë financuese	(200,000,007)	(110,000,000)
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë	24,446,345	(8,256,431)
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	105,866,473	114,122,908
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	130,312,818	105,866,477

Shënimet nga faqja 5 në 40 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

9.6. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale

Albsig sh.a SKEDULET PLOTESUESE

(Vlerat janë në Lek)

1. AKTIVE NË MBULIM TË PROVIZIONEVE TEKNIKE

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe rregullores nr. 19 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve tenike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve” akivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 gusht 2008, ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 dhjetor 2025:

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		4,224,246,502
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	19,354,000
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	122,000,000
I.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruar nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%	54,802,451
I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14:	30%	1,832,252,027
	<i>Qëllime shfrytëzimi</i>		1,832,252,027
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	2,195,838,025
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		1,964,401,480
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	130,312,818
III.5	d) Pjesën e risiguresit në provigjonet teknike, kur risiguresit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	97,672,306
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%	
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjionit të primit të pafituar;	20%	343,932,099
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.	5%	218,851,596
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	83,253,325
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit jeshil pranë BSHS	100%	6,054,173
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	1,084,325,163
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		6,188,647,982
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		5,111,496,412
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		4,540,777,900
VI.1	Provigjone të primit të pafituar		3,181,281,668
VI.2	Provigjone të dëmeve		1,359,496,232
VII	Tepriçë (+) / Mungesë(-) (V-VI)		570,718,512
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		112.57%

II

Albsig sh.a
SKEDULET PLOTESUESE

(Vlerat janë në Lek)

2. MARZHI I AFTËSISË PAGUESE

Sipas nenit 80 të ligjit 52”Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” niveli i kërkuar i Aftësisë Pagueuse të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë pagueuse. Niveli aktual i aftësisë pagueuse më 31 dhjetor 2025 është brenda limiteve të kërkuara.

Marzhi i aftësisë pagueuse duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2025 përbëhet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	2,272,614,263
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	879,460,000
I.c	Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	1,396,265,462
	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë:	
II	(II.a+II.b+II.c+II.ç)	3,111,200
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	-
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	764,763,405
	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	432,254,000
IV.a	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës	
IV.b		
V	Aktivët jolikuide (V.a deri V.g)	332,509,405
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	54,802,451
V.c	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90-ditor;	178,631,368
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	91,867,214
V.e	Elementet të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10)	
V.h	:	7,208,372
V.h-9	Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil	6,054,173
	Çdo zë tjetër në kundërshtim me kërkesat ligjore, rregullatore dhe vendime të Bordit të	
V.h-10	Autoritetit	1,154,199
VI	KAPITALI (Aftësia Pagueuse)	1,507,850,858
VII	Kufiri minimal i aftësisë pagueuse, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	718,989,458
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë pagueuse, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	1,078,484,187
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë pagueuse (VI-IX)	429,366,671
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

Albsig sh.a

SKEDULET PLOTESUESE

(Vlerat janë në Lek)

3. KUFIRI MINIMAL I AFTËSISË PAGUESE

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbejnë atë" koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b1 = koeficienti i pasigurisë, duke marrë në konsideratë shumën "a" është 0.18

b2 = koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë në konsideratë "a2" është 0.16

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2023 është brenda limiteve të kërkuara.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

Kufiri minimal i Aftësisë paguese, Jo Jete	ALBSIG SH.A.
1 1.Llogaritja me baze primet	
2 Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve	4,705,871,264
3 Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve	-
4 Taksa të zbritshme	249,219,437
5 Shuma "a" (5=2+3-4)	4,456,651,827
6 Pjesa e shumës "a" me e vogël se 1,000,000,000 leke (6=min(1,000,000,000,5))	1,000,000,000
7 Pjesa e shumës "a" me e madhe se 1,000,000,000 leke (7=5-6)	3,456,651,827
8 Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)	0.18
9 Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)	0.16
10 Total (10=6*8+7*9)	733,064,292
11 Deme të paguara bruto	1,189,698,695
12 Pjesa e risiguruesit në demet e paguara	8,771,277
13 Deme të paguara neto (13=11-12)	1,180,927,418
14 provigjone bruto të demeve në periudhën aktuale	1,359,496,233
15 provigjone bruto të demeve në fund të vitit të kaluar	1,084,705,704
16 pjesa e risiguruesve në provigjonet e demeve në periudhën aktuale	19,354,000
17 pjesa e risiguruesve në provigjonet e demeve në fund të vitit të kaluar	-
18 provigjone neto të demeve në periudhën aktuale (18=14-16)	1,340,142,233
19 provigjone neto të demeve në fund të vitit të kaluar (19=15-17)	1,084,705,704
20 ndryshimi në provigjonet e demeve bruto (20=14-15)	274,790,529
21 ndryshimi në provigjonet neto të demeve (21=18-19)	255,436,529
22 Deme të ndodhura bruto (22=11+20)	1,464,489,224
23 Deme të ndodhura neto (23=21+13)	1,436,363,947
24 Raporti i mbajtjes (24=max(0.5 , 23/22)	0.9808
25 Rezultati nga llogaritja me baze primet (25=24*10)	718,989,458

10 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE VJETORE

Misioni i Shoqërisë ALBSIG SH.A. është dhe do të mbetet stabiliteti financiar dhe e ardhmja e sigurt për stafin, klientët dhe bashkëpunëtorët tanë; të sigurojmë zhvillim profesional dhe personal të stafit tonë e njëkohësisht të krijojmë partneritet të fortë me klientët duke ofruar mbështetje të plotë e të vendosur për t'u bërë zgjedhja e parë e çdo shqiptari. Veprimtaria e shoqërisë mbështetur në ekperiencën e saj në tregun e sigurimeve jo-jetë, zhvillimeve e tregut si dhe burimeve njerëzore ka përcaktuar objektivat e mëposhtme:

- Pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;
- Struktura organizative për marrjen në sigurim sipas linjave të sigurimit, por dhe shtimi i degëve të reja që janë rritur ndjeshëm në numër në vitet e fundit do të jetë faktor i rëndësishëm për pozicionimin në treg. Ngritja e nivelit profesional të punonjësve/ekspertëve të marrjes në sigurim, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe trajnimit për linjat kryesore dhe të reja të biznesit, duke i dhënë prioritet paketave të sigurimit vullnetar dhe kërkesave të tregut duke gjeneruar produkte të reja për të qenë sa më afër klientit dhe për ti dhënë një mbrojtje klientit dhe bizneseve.
- Rritja dhe mbulimi i provigjioneve teknike me burime të mjaftueshme financiare, diktuar nga:
 - Zgjerimi i gamës së produkteve;
 - Impulset pozitive të rritjes në tërësi të të ardhurave nga linjat e sigurimit vullnetar.
- Perfeksionimi i linjave të biznesit nëpërmjet implementimit të skemave sa më optimale të shërbimit informatik, udhëzimeve etj.
- Cilësia e shërbimit të drejtpërdrejtë ndaj klientit e shprehur me një proces efektiv dhe cilësor të marrjes në sigurim dhe me pagesën e shpejtë dhe cilësore të dëmeve të shprehur me nivelin e pagesave dhe provigjionimin real të dëmeve, që përfundimisht do të cojnë në raporte dëme / prime ndjeshëm më të larta se aktualet e tregut.
- Lidhja e marrëveshjeve dhe kontratave efektive të risigurimeve me risigurores seriozë në funksion të rritjes së kapacitetit mbajtës dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të shoqërisë.
- Hartimi dhe vënia në funksionim e një programi fleksibël dhe efektiv për rekrutimin, motivimin dhe rritjen cilësore të burimeve njerëzore të shoqërisë. Programet e vazhdueshme të trajnimit në punë, brenda dhe jashtë vendit në të gjitha proceset e sigurimeve dhe ato mbështetëse do të jetë prioritet për shoqërinë.

Këto objektiva strategjike do të ndihmojnë në përcaktimin e një vizioni të qartë dhe në zhvillimin e rekomandimeve për të përmirësuar shoqërinë Albsig sh.a. në të ardhmen.

- **Analiza e Tregut dhe Identifikimi i Mundësive të Rritjes:** Studimi i përqindjes së tregut për çdo segment të sigurimeve dhe identifikimi i sektorëve potenciale për rritje.
- **Inovacioni dhe Përdorimi i Teknologjisë:** Identifikimi i inovacioneve të fundit dhe përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar përvojën e klientit, si dhe efikasitetin operacional të Albsig sh.a.. Analiza e avantazheve dhe sfidave të përdorimit të teknologjisë në sektorin e sigurimeve në Shqipëri.
- **Përmirësimi i Performancës Financiare:** Vlerësimi i performancës financiare të Albsig sh.a. duke përfshirë analizën e rritjes së fitimit, efikasitetit të kostove dhe menaxhimit të rrezikut financiar. Identifikimi i strategjive për të përmirësuar performancën financiare dhe stabilitetin e shoqërisë Albsig sh.a. në treg.
- **Zhvillimi i Produktit dhe Diversifikimi:** Zhvillimi i produkteve të reja të sigurimeve që përputhen me nevojat e klientit të ndryshuar dhe tendencat e tregut. Identifikimi i mundësive për diversifikim të ofertës së produkteve dhe analiza e rrezikut të lidhur me zgjerimin e portofolit të produkteve.
- **Përqasja ndaj Sfidave dhe Rrjedhës së Rregullatorëve:** Përcaktimi i sfidave kryesore dhe ndikimit të rregullatorëve në tregun e sigurimeve në Shqipëri. Analiza e rregullimeve të reja dhe strategjitë për të përshtatur me ndryshimet në mjedisin rregullator.

Këto objektiva strategjike do të ndihmojnë në përmirësimin e analizës dhe raportimit në raportin vjetor për sektorin e sigurimeve në Shqipëri, duke siguruar një vizion të qartë strategjik dhe rekomandime për të ardhmen e tregut të sigurimeve.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

info@albsig.al
www.albsig.al

+355 (0) 44502060 / +355 (0) 42254770

ALBSIG sh.a.
Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17,
1010 – Tirana, Albania